

Pjesa 2

Marrja e përgjegjësisë

Njësia 5

**Të drejtat, liritë dhe përgjegjësitë
Cilat janë të drejtat tona dhe si mbrohen ato?**


Njësia 6

**Përgjegjësia
Çfarë përgjegjësish kanë njerëzit?**

NJËSIA 5

Të drejtat, liritë dhe përgjegjësitë

Cilat janë të drejtat tona dhe si mbrohen ato?



5.1. Dëshirat, nevojat themelore, dinjiteti njerëzor dhe të drejtat e njeriut

A gëzoj unë të drejtë të njeriut për çdo gjë që unë e dëshiroj?

5.2. Zbulimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut

Cila e drejtë e njeriut është shkelur këtu?

5.3. Të drejtat dhe përgjegjësitë

Si mund të ekzistojnë të drejtat pa përgjegjësitë?

5.4. Kuiz (test) për të drejtat e njeriut

Çka është e drejtë? Cilat duhet të jenë të drejtat e njeriut?

NJËSIA 5: Të drejtat, liritë dhe përgjegjësitë Cilat janë të drejtat tona dhe si mbrohen ato?

Të drejtat e njeriut, në një rëndësi anë, merren me zhvillimin e qenieve njerëzore, d.m.th. sa ata janë në gjendje të vënë në jetë potencialin e tyre të plotë në marrëdhëniet me bashkëqytetarët e tyre. Në anën tjetër, të drejtat e njeriut përcaktojnë përgjegjësitë e shtetit komb ndaj individëve. Dokumentet e rëndësishme mbi të drejtat e njeriut përfshijnë Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës. Tradicionalisht, të drejtat e njeriut janë ndarë në kategori – të drejtat civile, politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Këto kategori shpesh shoqërohen me etapat e zhvillimit të historisë së të drejtave të njeriut, ku të drejtat civile dhe politike konsiderohen si “gjenerata e parë”, pasuar nga të drejtat sociale dhe ekonomike si “gjenerata e dytë” dhe të drejtat kulturore ose të drejtat për zhvillim që konsiderohen si “gjenerata e tretë”. Pavarësisht vlerës së kategorizimit të të drejtave, EQD/EDNJ-ja kërkon promovimin e të kuptuarit të të drejtave të njeriut pa bërë dallime. Të gjitha kategoritë i konsideron të një rëndësie të njëjtë: civile, politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Pra, EQD/EDNJ-ja përpiket të balancojë tendencën e të kaluarës për të konsideruar të drejtat e caktuara si më të rëndësishme se të tjerat. Derisa të drejtat e njeriut tradicionalisht janë shoqëruar me shtetin dhe marrëdhëniet e tij me individët, EQD/EDNJ-ja gjithnjë e më shumë e vë theksin në të drejtat e grupeve ose të popujve. Përpjekjet për të përfshirë këto ide në EQD/EDNJ janë të rëndësishme për zhvillimin e vetë konceptit dhe për zhvillimin e komuniteteve lokale, nacionale dhe rajonale.¹⁹

Të drejtat e njeriut i kanë tri elemente: bartësin e të drejtave, përmbajtjen e të drejtës (çfarë ka të drejtë të kërkojë bartësi) bartësin e detyrimit (personi ose institucioni që duhet t’i përgjigjet kërkesës). Detyrimet zakonisht vlerësohen në tri nivele:

- Të respektosh do të thotë të përmbahesh nga privimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i të drejtave të individëve, duke përfshirë edhe përmbajtjen nga krijimi i një sistemi institucional, i cili do t’i privonte njerëzit nga të drejtat e tyre apo nga stimulimi i të tjerëve për të privuar njerëzit nga të drejtat e tyre.
- Të mbrosh do të thotë të zbatosh këtë respekt; të parandalosh ata të cilët duan të privojnë tjetrin nga të drejtat e tij – qofshin ata zyrtarë qeveritarë, institucione ndërkombëtare, korporata private, udhëheqës të komunitetit, anëtarë të komitetit apo anëtarë të familjes – që këtë të mos e bëjnë.
- Të përmbushësh do të thotë të ndihmësh të privuarit – duke përfshirë edhe ata për të cilët kemi përgjegjësi speciale, ata të cilët janë privuar sepse nuk është kryer detyrimi për të respektuar dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre, dhe ata të cilët janë viktimat e katastrofave natyrore. Kjo ndihmë përfshin ndërmarrjen e veprimeve legjislative, buxhetore, gjyqësore dhe të tjera për të siguruar ambientin më të mirë të mundshëm, ku mbizotërojnë parimet për mbrojtjen e të drejtave.²⁰

Liritë e mbrojtura si të drejta civile përfshijnë lirinë e mendimit, të opinionit dhe të shprehjes, lirinë e besimit religjioz dhe praktikimit të atij religjioni, lirinë e lëvizjes brenda shtetit dhe të drejtën për tubim paqësor dhe në shoqata (shoqëri). Të drejtat tjera civile mbrojnë privatësinë e individit, jetën familjare dhe të drejtën e barazisë para ligjit.²¹

Përgjegjësitë janë rrjedhojë logjike e të drejtave të njeriut. Për t’u mbrojtur, çdo e drejtë bart përgjegjësitë përkatëse, edhe për qytetarët edhe për shtetin. Çdo individ ka detyrim moral që të mos cenojë dinjitetin personal të tjetrit. Qeveritë, me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe të detyruar me kushtetutat e tyre, nuk kanë vetëm obligim moral, por edhe detyrim ligjor.

19. Nga “Fjalori i termave të edukimit për qytetarinë demokratike” (“A glossary of terms for education for democratic citizenship”), Karen O’Shea, Këshilli i Evropës, DGIV/EDU/CIT (2003) 29.

20. Bazuar në “Duties sans Frontières. Të drejtat e njeriut dhe drejtësia globale shoqërore”, International Council of Human Rights Policy.

21. Po aty.

Edukimi për Qytetarinë Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

Përmes kësaj serie të mësimëve nxënësit do të:

- kuptojnë më mirë natyrën e të drejtave të njeriut: ato janë parakushte që çdo njeriu i mundësojnë të jetojë me dinjitet;
- zgjerojnë njohuritë e tyre për këto të drejta dhe kuptojnë si funksionojnë të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht;
- rrisin aftësitë e tyre për të njohur shkeljet e të drejtave të njeriut;
- zgjerojnë njohuritë e tyre se si ata mund të kontribuojnë në përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut;
- zgjerojnë njohuritë dhe rrisin vetëdijen e tyre për përgjegjësitë që lidhen me të drejtat e njeriut: përgjegjësitë e shtetit dhe të institucioneve, si dhe përgjegjësitë e tyre morale.

NJËSIA 5: Të drejtat, liritë dhe përgjegjësitë

Cilat janë të drejtat tona dhe si mbrohen ato?

Titulli i mësimit	Objektivat	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metoda
Mësimi 1: Dëshirat, nevojat themelore, dinjiteti njerëzor dhe të drejtat e njeriut	Nxënësit mund të tregojnë se të drejtat e njeriut janë parakusht që çdo njeri të mund të jetojë me dinjitet.	Nxënësit i lidhin dëshirat e tyre me nevojat themelore dhe me të drejtat e njeriut.	Prospektet për nxënës 5.1. Prospektet për nxënës 5.2 (mësimdhënësi duhet t'i njoftojë nxënësit se këto prospekte për nxënës përdoren gjatë tërë njesisë dhe kështu do të nevojiten edhe në mësimet tjera).	Punë në grupe, punë plenare. Të menduarit kritik.
Mësimi 2: Zbulimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut.	Nxënësit mund të identifikojnë shkeljet e të drejtave të njeriut.	Nxënësit studiojnë rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut.	Prospektet për nxënës 5.3. Prospektet për nxënës 5.2.	Punë në çifte ose në grup. Diskutim plenar.
Mësimi 3: Të drejtat dhe përgjegjësitë	Nxënësit kuptojnë se si ata mund të kontribuojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nxënësit kuptojnë se të drejtat e njeriut janë të lidhura me përgjegjësitë – përgjegjësitë e shtetit dhe të institucioneve, si dhe përgjegjësitë e tyre morale.	Nxënësit identifikojnë përgjegjësitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe kontributet e tyre personale.	Fletë e bardhë e letrës dhe stilograf Prospektet për nxënës 5.4. Prospektet për nxënës 5.2.	Punë në çifte ose në grup. Të menduarit kritik.
Mësimi 4: Kuizi (testi) për të drejtat e njeriut	Nxënësit mësojnë për të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht.	Nxënësit përgjigjen në pyetjet me më shumë alternativa të përgjigjes dhe diskutojnë implikimet e përgjigjeve të tyre.	Skeda për çdo nxënës me zgjedhjet në anën e pasme (prospektet për nxënës 5.5).	Pyetje me zgjidhje të shumfishta

Mësimi 1**Dëshirat, nevojat themelore, dinjiteti njerëzor dhe të drejtat e njeriut****A gëzoj unë të drejtë të njeriut për çdo gjë që unë e dëshiroj?**

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësit mund të tregojnë se të drejtat e njeriut janë parakushte të nevojshme që çdo njeri të jetojë me dinjitet.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit i lidhin dëshirat e tyre me nevojat (e tyre) themelore dhe me të drejtat e njeriut.
Burimet	Prospektet për nxënës 5.1 (një material për çdo grup me katër apo pesë nxënës). Prospektet për nxënës 5.2 (një fletushkë për çdo grup me katër apo pesë nxënës).
Metoda	Punë në grupe, punë plenare. Të menduarit kritik.

Konceptet

Është me rëndësi që të jeni në gjendje të bëni dallimin në mes të **dëshirës** dhe **nevojës themelore**. Nevojat themelore të njerëzve, të cilat duhet të përmbushen për t'u mundësuar atyre të jetojnë me dinjitet, mund të konsiderohen si bazë mbi të cilën janë formuar të drejtat e njeriut.

Në këtë mësim ka mundësi të bëhet punë me postera dhe të menduarit kritik si aktivitete shtesë.

Mësimi

Për të paraqitur mësimin, mësimdhënësi i njofton nxënësit për organizimin e mësimin, por nuk duhet të hyjë në detaje sa i përket temës kryesore. Nxënësit fillojnë duke i bërë pyetje vetes dhe njëri tjetrit për dëshirat dhe nevojat e tyre – ata më vonë në mësim do të shohin se shumica prej tyre korrespondojnë me të drejtat njeriut. Pas hyrjes (jo më shumë se një apo dy minuta) nxënësit ndahen në grupe të vogla me nga katër apo pesë, dhe atyre u jepen detyrat në dy faza. Mësimdhënësi së pari shpjegon detyrën 1, dhe në mënyrë individuale grupeve u shpjegon hapin e ardhshëm kur ata të kenë mbaruar. Në këtë mënyrë, kujdesemi për suksesin e të nxënës individual të nxënësve.

- **Detyra 1:** Prospektet për nxënës 5.1, Dëshirat, nevojat dhe të drejtat. Grupet bëjnë një listë të dëshirave të tyre “materiale” (p.sh. “një shujtë e mirë”) në kolonën e majtë të fletës së punës dhe shtojnë së paku tri dëshira “jomateriale” (p.sh. “të të dashurojë dikush”). Ata pastaj mendojnë për nevojat që paraqesin këto dëshira dhe ato i shtojnë në kolonën e mesme.
- **Detyra 2:** Në vijim mësimdhënësi u jep grupeve që kanë mbaruar me detyrën 1 kopje të prospektëve për nxënës 5.2, Listën e të drejtave të njeriut, dhe kërkon që ata të shkruajnë të drejtën përkatëse në kolonën e fundit (p.sh. “të drejtën për ushqim”, “lirinë nga diskriminimi”).
- **Detyra 3:** Grupet që kanë mbaruar herët duhet të fillojnë të mendojnë për përgatitjen e posterit për të drejtat e njeriut duke zgjedhur njërin nga nevojat dhe të drejtën përkatëse. Ata duhet të diskutojnë për përmbajtjen e konceptit të tyre dhe këtë ta shikojnë gjithashtu nga pikëvështrimi artistik, dhe pastaj të bëjnë një projektpropozim.

Pasi të përfundojë puna në grupe, mësimdhënësi mund të shkruaj mendimet e grupeve në dërrasën e zezë. Ai vizaton një tabelë me tri kolona dhe kërkon nga përfaqësuesi i çdo grupi të shtojnë një dëshirë, një nevojë dhe të drejtën përkatëse. Kjo vazhdon derisa kemi një listë me dhjetë dëshira, nevoja dhe të drejta në dërrasën e zezë (nëse është e mundshme, përdorni tabelën shfletuese (flip chart), meqë fletët mund të ngjiten në muret e klasës për të përkujtuar grupet për diskutimet e tyre).

Në vijim mësimdhënësi drejton një diskutim të shkurtër plenar duke përdorur idetë vijuese:

- “Keni konstatuar se dëshirat dhe nevojat e juaja korrespondojnë me idetë e Konventës mbi të Drejtat e Njeriut. Për këtë nevojiten disa shpjegime!”
- “Disa të drejta nga Konventa ne nuk i kemi menduar. Ato mund të mos jenë të rëndësishme ose janë të përfshira në ndonjë të drejtë tjetër. Cili është mendimi juaj?”
- “Shikoni këtë listë të të drejtave të njeriut. Kur të mendoni se çka u nevojitet për të jetuar një jetë të denjë apo çka u nevojitet njerëzve të tjerë në rajone, shtete apo kontinente të tjera, çka mungon? Çfarë të drejtash tjera të njeriut do të shtonit?”

Për të përfunduar diskutimin, mësimdhënësi informon nxënësit se zhvillohet debat mbarëbotëror për fokusin kryesor të të drejtave të njeriut. Njëri prej konkludimeve është: “Të drejtat e njeriut nevojiten për të lejuar secilin të jetojë me dinjitet.” Mësimdhënësi pastaj kërkon që nxënësit të mendojnë për alternativa të këtij konkludimi. Kjo mund të jetë detyrë shtëpie. Nëse është e mundshme, gjatë ditëve të ardhshme, nxënësit duhet të shtojnë idetë e tyre në fletët e letrës që janë ngjitur në muret. Në këtë mënyrë, mund të vazhdojë procesi i të menduarit.

Si detyrë shtesë, nga nxënësit mund të kërkohet të përgatisin postera për temën e të drejtave të njeriut, duke përdorur copa të prera nga gazetata, copa të prera nga revistat ose vizatime dhe piktura të bëra nga vetë ata. Këto mund të përdoren për dekorime të klasës apo për ekspozitë.

Në fund, për të përmbledhur, mësimdhënësi bën një rishikim të shkurtër të mendimeve dhe qëllimeve të mësimin. Ai mund edhe të shpjegojë parimin didaktik të konceptit të tij për të bërë hyrjen: d.m.th., të fillojë me shikimin e përvojës dhe të ideve personale dhe të përfundojë duke shpjeguar konceptin apo teorinë.

Mësimi 2**Zbulimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut**

Cila e drejtë e njeriut është shkelur këtu?

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësit mund të identifikojnë shkeljet e të drejtave të njeriut.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit studiojnë raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut.
Burimet	Prospektet për nxënës 5.3 për çdo çift të nxënësve. Prospektet për nxënës 5.2 për çdo çift të nxënësve.
Metodat	Punë në çifte ose në grup. Diskutim plenar.

Kuti informacioni

Shkelja dhe cenimi i të drejtave të njeriut ndodhin çdo ditë, në mbarë botën. Duke shikuar rastet e vërteta nga e kaluara ose e tanishmja, nxënësit fitojnë një pasqyrë më të qartë dhe më precize se çka janë të drejtat e njeriut.

Mësimi

Mësimi fillon me diskutimin e detyrave dhe rezultateve nga mësimi i kaluar. Paraqiten posterat dhe bëhet krahasimi i listës së konkluzioneve. Nëse është e dobishme dhe e mundshme, propozimet shënohen në fletë të letrës dhe ngjiten me gjilpëra në muret e klasës, së bashku me posterat.

Në vazhdim nxënësit formojnë çiftet. Çdo çifti i jepet një kopje e prospekteve për nxënësin 5.3, Shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe një kopje e prospekteve për nxënësin 5.2, Lista e të drejtave të njeriut.

Lista e shembujve të shkeljeve të të drejtave të njeriut ndahet në mes të çifteve; për shembull çiftit 1 mund t'i jepet a-d, çiftit 2 e-j, etj.

Është e pëlqyeshme që lista të ndahet ashtu që çdo grup i shkeljeve të rishqyrtohet nga më shumë se një çift i nxënësve.

Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë shembullin e një rasti të shkeljes së të drejtave të njeriut. Ata pastaj mundohen të pajtohen për të drejtën e njeriut nga lista e cila është cenuar apo shkelur; d.m.th., në shembullin a, e drejta e cila është shkelur është e drejta nr. 10.

Përgjigjet diskutohen në klasë. Dobia e të pasurit më shumë se një çift duke punuar në një shembull do të thotë se nëse ka dallime të opinionëve, diskutimet mund të drejtohen përmes një serie të pyetjeve të shkurta:

- Si arritët në opinionin tuaj?
- Kur dëgjuat përgjigjet e çifteve të tjera, a u bëri kjo që të dëshironi të ndërroni përgjigjen tuaj? Nëse po, çka u bindi juve? Pse?

Qëllimi i diskutimit është që të shqyrtohen disa nga shembujt dhe përgjigjet, në vend që të mendohet se vetëm një përgjigje është e saktë.

Aktivitet shtesë

Nëse ka ende kohë në fund të mësimit, mësuesi mund të pyes nxënësit se cili nga këto shembuj konkretë ju bën më shumë përshtypje. Për disa nga shembujt e dhënë, nxënësit mund të pyeten:

- Si do të ndiheshit ju po t'ju ndodhte kjo juve?
- Si do të reagonit ju?
- Çka besoni ju se do të bënin njerëzit tjerë?

Pyetjet e tilla mund të ndihmojnë nxënësit të eksplorojnë idenë se të tjerët kanë përgjegjësi të veprave në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Prospektet për nxënës 5.3**Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut****Kopja e mësimdhënësit me zgjidhjet**

Cenimi apo shkelja e të drejtave të njeriut	Të drejtat e shkelura të njeriut (DNJ)
a. Znj. X, e cila para ca vitesh e humbi vajzën dhe burrin e saj në një aksident automobilistik, nuk mund të martohej me burrë tjetër pa dhënë leje të qartë kunati i saj.	10
b. Rojet e burgut i përdorën qentë për të frikësuar dhe kërcënuar të burgosurit me sulme, dhe në një rast ata detyruan qentë të kafshojnë një të burgosur.	2
c. Në një fabrikë lokale, punëtorët duhet të punojnë për së paku 10 orë në ditë pa pushim.	21
d. Që nga arrestimi i tyre, tre burra kanë pasur probleme për qasje në avokat. Avokatët kishin ardhur shumë herë por atyre nuk u ishte lejuar që t'i shohin këta të arrestuar; burrave nuk u lejohej që të zhvillojnë diskutime të përbashkëta me avokatët e tyre, që në të vërtetë do të thoshte se dy prej tyre nuk kishin qasje në avokatët e tyre.	5
e. Një grua, e cila e kryen saktësisht punën e njëjtë dhe e ka moshën dhe përvojën e njëjtë sikurse kolegu i saj mashkull, ka marrë pagë më të ulët se ai.	7
f. X e rrëmbeu dhe e arrestoi Y për tri ditë dhe e gjuajti atë në kokë, gjë që pasoi me vdekjen e tij pas 3 ditësh.	1
g. Znj. X, e varur nga droga, ishte fotografuar kur ajo po largohej nga një takim anonim i narkotikëve. Më vonë kjo fotografi ishte publikuar.	9
h. Një grua, e keqtrajtuar nga burri i saj, kishte mundur të shkurorëzohet atëherë kur atij i kishte dhënë shtëpinë, veturën dhe tërë pasurinë e saj. Asaj nuk i kishte mbetur asgjë.	11
i. X, e cila vuante nga pneumonia me rrezik për jetën, nuk i kishin ofruar trajtim mjekësor në spital, meqë ajo kishte hyrë ilegalisht në këtë shtet.	18
j. Shtatëdhjetë për qind e popullatës në zonën X ishin detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, dhe më vonë i kishin penguar që të kthehen. Atyre nuk u lejohej të largohen nga kampet e tyre për të shkuar në fushat e afërta për të kultivuar të mbjellat e tyre, dhe u ndalohej udhëtimi nëpër shumë rrugë.	12
k. Afrikanët e zi i blinin në Afrikë, për shembull, për një shishe uiski, dhe shiteshin në Amerikën Veriore ndërmjet 1 200 dhe 1 500 dollarë amerikan.	3
l. Në shtetin X, të gjitha mjetet e jetesës për popullatën vendore qëllimisht janë shkatërruar: të mbjellat, furnizimi me ujë dhe bagëtia.	17
m. Në shtetin X, qytetarët mund të burgosen pa u akuzuar.	4
n. Një reporter 26-vjeçar i një gazete ditore, ishte qëlluar për vdekje në një sulm të dyshimtë raprezaliesh, për mbulimin e fushatës zgjedhore të posa përfunduar.	15
o. Z. X ishte thirrur për t'u regjistruar në ushtri. Ai i shkroi zyrës ushtarake duke deklaruar kundërshtimin e tij të ndërgjegjshëm për shërbimin ushtarak dhe refuzoi të paraqitet për shërbim ushtarak. Ai ishte akuzuar për mosbindje dhe ia kishin ndaluar që të largohet nga vendi.	14
p. Në shtetin X, ata të cilët duan t'i përkasin religjionit Falun Gong janë të ndaluar që të mblidhen.	16
q. Shumica etnike urdhëroi që, ata të cilët u përkasin grupeve minoritare, siç janë populli çifut dhe rom, obligohen të jetojnë në zona të caktuara të qytetit.	25

Cenimi apo shkelja e të drejtave të njeriut	Të drejtat e shkelura të njeriut (DNJ)
r. Fëmijët të cilët jetojnë në fshat nuk kanë mundësi të vijojnë shkollën fillore, meqë një shkollë e tillë nuk është në dispozicion brenda një distance të arsyeshme.	19
s. X nuk mund të vë kandidaturën për zgjedhjet parlamentare, sepse autoritetet religjioze të shtetit nuk e kanë pranuar atë.	23
t. Duke qenë i zi, X nuk mund të punësohet si mjek në spitalin lokal.	20
u. Në disa shtete njerëzit e varfër nuk kanë qasje në programe të ushqimit apo të strehimit, as në shërbime shëndetësore të përballueshme për ata.	26
v. Z. X, shtëpia e të cilit është djegur, nuk mund të paraqiste kërkesë për kompensim.	6
w. X, një grua 47 vjeçare, e cila gjithmonë ka punuar në shtëpi si amvise dhe nënë e pesë fëmijëve, i humb të gjitha përfitimet nga sigurimi social pasi shkurorëzohet nga burri i saj.	22
x. Z. X, baba i dy fëmijëve, ishte burgosur dhe torturuar në shtetin X për shkrimin e poemave me të cilat kritikoi regjimin në pushtet. Kërkesa e tij për azil politik në shtetin A ishte hedhur poshtë. Ai tha se do të përballej me tortura po të kthehej në vendlindje, meqë ai tani është i obliguar që të kthehet.	13
y. Për të ashtuquajturat arsye praktike, njerëzit e paaftë fizikisht, siç janë shfrytëzuesit e karrocës për invalidë, nuk lejohen të marrin pjesë në ngjarje kulturore në teatrin lokal.	24
z. Për të aplikuar për nënshtetësi në shtetin X, kërkohet banim për një periudhë 15 vjeçare, një test i shëndetit fizik dhe mental, si dhe taksë administrative, e cila është e lartë pa arsye. Si pasojë e kësaj, me mijëra rom, të cilët kanë lidhje të vjetra me vendin e tyre, janë pa shtetësi në shtetin e tyre.	8

Mësimi 3**Të drejtat dhe përgjegjësitë****Si mund të ekzistojnë të drejtat pa përgjegjësi?**

Objektivat e mësimnxënies	Nxënësit kuptojnë si ata mund të kontribuojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nxënësit kuptojnë se të drejtat e njeriut janë të lidhura me përgjegjësitë – përgjegjësitë e shtetit dhe të institucioneve, si dhe përgjegjësitë e tyre morale.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit identifikojnë përgjegjësitë për të mbrojtur të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe kontributet e tyre personale.
Burimet	Fletë e bardhë e letrës dhe stilograf. Prospektet e nxënësve 5.4 për çdo çift të nxënësve. Prospektet e nxënësve 5.2 për çdo çift të nxënësve.
Metodat	Punë në çifte ose në grupe. Të menduarit kritik.

Kuti informacioni

Një e drejtë e njeriut asnjëherë nuk do të respektohet nëse një individ apo autoritet nuk merr përgjegjësinë për realizimin e saj. Edhe pse qeveritë janë bartësit kryesor të detyrimeve në këtë rast, ka shumë nevojë që organet tjera dhe individët të promovojnë dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut. Çdo individ ka përgjegjësi morale t'i kontribuojë një kulture në të cilën vlerat e të drejtave të njeriut shkaktojnë sjelljen tonë në jetën e përditshme.

Një aktivitet i mundshëm shtesë do të ishte paraqitja e temës mbi të drejtat pozitive dhe negative dhe puna me projekte.

Mësimi

Nxënësit formojnë çifte. Është me rëndësi që në klasë të ketë numër të barabartë të çifteve.

Çdo çifti i jepet një fletë e bardhë e letrës dhe stilograf dhe nga ata kërkohet që të shënojnë tri të drejta të rëndësishme të cilat ata mendojnë se duhet t'i kenë në shkollë, dhe tri të drejta të rëndësishme të cilat ata mendojnë se duhet t'i kenë në shtëpi. Shembujt mund të jenë e drejta për të mos u mbingarkuar me detyra shtëpie ose e drejta për të marrë ca para xhepi.

Pasi të përfundohet kjo, mësimdhënësi i shpërndan çdo çifti kopjen e prospekteve për nxënës 5.4, Të drejtat dhe përgjegjësitë, dhe prospektet për nxënës 5.2, Lista e të drejtave të njeriut. Nga nxënësit kërkohet që të shqyrtojnë listën e të drejtave të njeriut dhe të diskutojnë se cilat të drejta më së miri korrespondojnë me gjashtë të drejtat të cilat ata i kanë shënuar në fletën e tyre të letrës.

Pasi të kenë vendosur, ata i shkruajnë gjashtë të drejtat në kolonën e parë të prospekteve për nxënës 5.4. Tani mësimdhënësi mund të pyes nxënësit nëse ata kanë nevojë për ndonjë sqarim për të drejtat që i kanë shënuar.

Pasi të kompletohet kolona e parë, mësimdhënësi u shpjegon nxënësve se çdo e drejtë bart përgjegjësi gjegjëse, duke u dhënë shembullin vijues: “Liria e fjalës është e kufizuar me përgjegjësinë për të mos thënë gjëra të pavërteta, të cilat do të degradonin personin tjetër dhe do të shpërdoronin të drejtën e tij për dinjitet dhe reputacion të mirë.” Mësimdhënësi gjithashtu mund t'u shpjegojë se ekuilibri i të drejtave të njeriut dhe përgjegjësitë e tij për të respektuar të drejtat e njerëzve të tjerë do të thotë se ne duhet të ushtrojmë të drejtat tona në kuadër të disa kufizimeve të caktuara. Ka shumë situata në të cilat të drejtat dhe përgjegjësitë e njerëzve të ndryshëm janë në konflikt. Për shembull, në klasë, e drejta për edukim mund të jetë në konflikt me të drejtën për kohë të lirë, kur disa nxënës duan të mësojnë derisa të tjerët preferojnë vetëm të argëtohen. Për më tepër, shkolla ka përgjegjësi t'i mësojë dhe edukojë nxënësit dhe të sigurojë që mësimdhënësit të kenë të drejtë në kushte të përshtatshme pune (siç është të mos kenë shumë zhurmë në ambientin e tyre të punës).

Mësimdhënësi në vijim kërkon që çdo çift i nxënësve t'i shkëmbejë listat e tyre me një çift tjetër. Çifti i ri në vijim duhet të diskutojë shembuj të dy niveleve të përgjegjësisë që korrespondojnë me çdo të drejtë të shënuar nga çifti tjetër (shih shembullin më poshtë):

- Niveli i parë: përgjegjësinë që e kanë individët për të siguruar që të tjerët të mund të gëzojnë të drejtën (kjo duhet të shkruhet në kolonën e dytë).
- Niveli i dytë: përgjegjësitë (aty ku ekzistojnë) për autoritetet (siç është shkolla apo autoritetet lokale) për të siguruar këtë të drejtë. Kjo duhet të shënohet në kolonën e tretë. Për shembull, përgjegjësia e çdo individi për të respektuar privatësinë e ditari të nxënësve të tjerë; përgjegjësia e shkollës për të mos kontrolluar gjërat personale të individit kur kjo është e panevojshme (për shembull, të mos lexohet ditari derisa klasa kontrollohet për një kalkulator të vjedhur).

E drejta e njeriut (në shkollë, në shtëpi)	(Përgjegjësia (morale) e individit	Përgjegjësia e shkollës, e autoritetit, etj.
E drejta për privatësi	Të mos shikosh në ditarin e tjetërkujt	Të mos lexohet ditari i nxënësit kur kontrollohen gjërat personale të individit në rast të vjedhjes

Pastaj, mësimdhënësi mund të pyes çdo çift t'i raportojë klasës për një të drejtë dhe për përgjegjësitë përkatëse nga listat e tyre.

Meqë theksi i këtij mësimi është në përgjegjësitë, mësimdhënësi mund të vendosë të vizatojë dy kolona në dërrasën e zezë, një për përgjegjësitë individuale, tjetrën për përgjegjësitë e autoriteteve, dhe derisa nxënësit japin shembuj, këto mund të shënohen në dërrasën e zezë. Mësimdhënësi mund të përfundojë orën me një rishikim të përgjegjësive dhe të kërkojë që nxënësit të komentojnë për listat.

Aktivitet shtesë

Nëse premtan koha, ose nëse mësimdhënësi dëshiron të vazhdojë mësimin për të përfshirë idenë e të drejtave pozitive dhe negative dhe punën me projekte, ai mund të kryej aktivitetet vijuese.

Mësimdhënësi mund të fillojë duke shpjeguar se të drejtat e njeriut ndonjëherë ndahen në “të drejta negative” dhe “të drejta pozitive”.

Të “drejta negative” janë të drejta të cilat ndalojnë apo pengojnë diçka të pakëndshme (siç është ndalimi i torturës). Të “drejtat pozitive” janë të drejta që në mënyrë të qartë kërkojnë që dikush të bëjë diçka apo të ketë bërë diçka (siç është e drejta për ushqim: çdokush ka të drejtë të ketë ushqim të mjaftueshëm). Ndonëse të “drejtat negative” nuk presin që njerëzit të kryejnë veprime të caktuara, të “drejtat pozitive” presin që individët dhe autoritetet të kryejnë veprime të caktuara për të siguruar këto të drejta.

Mësimdhënësi gjithashtu u shpjegon se shumica e të drejtave të njeriut kanë edhe anë negative edhe pozitive. Për shembull, e drejta për të mos u torturuar do të thotë se autoritetet nuk duhet të keqtrajtojnë njerëzit të cilët janë të burgosur, por do të thotë gjithashtu se autoritetet duhet t’u japin udhëzime të qarta forcave policore lidhur me këtë.

Nga nxënësit kërkohet që ata t’u kthehen listave të tyre të të drejtave të njeriut dhe të zgjedhin tri prej tyre. Ata duhet të kërkojnë shembuj të veprimeve pozitive apo negative në jetët e tyre për të treguar përgjegjësinë e tyre morale. Ata pastaj duhet të kërkojnë shembuj të tjerë, këtë herë për të treguar përgjegjësinë e shkollës apo të autoriteteve lokale/vendore. Për këtë qëllim, ata mund t’u shënojnë shenjën e plusit ose të minusit përgjegjësive që i kanë zgjedhur: shih shembullin më poshtë.

Nëse mësimdhënësit dëshirojnë që këtë aktivitet ta shfrytëzojnë si hyrje për punën me projekte, ata

Të drejtat e njeriut (në shkollë, në shtëpi)	Përgjegjësia (morale) e individit	Përgjegjësia e shkollës, e autoritetit, etj.
E drejta në privatësi (= shembull)	(+)	(+) Të kujdeset që dosjet e nxënësve të shkollës të mos shikohen nga vizitorët
	(-) Të mos shikosh ditarin e dikujt tjetër pa u kërkuar nga ju që këtë ta bëni	(-) (shkolla) Të mos kontrollojë gjërat personale të dikujt nëse kjo striktivisht nuk është e nevojshme (-) (shteti) Të sigurojë legjislacionin për mbrojtjen e privatësisë së individëve

mund të kërkojnë nga nxënësit që të zgjedhin disa nga të drejtat e njeriut të cilat do të trajtohen më hollësisht gjatë javëve apo muajve të ardhshëm. Pastaj nxënësit përpilojnë një plan dhe pajtohen për objektivat e përgjithshme të këtij plani, si dhe për hapat e ndryshëm që duhet të ndërmerren. Ata gjithashtu vendosin se kur duhet të kryhet çdo detyrë dhe nga kush.

Plani

Objektivi i përgjithshëm:		
Çka duhet bërë?	Kush do ta bëjë?	Kur duhet kjo të jetë e gatshme?

Gjatë disa mësimëve të ardhshme, ky plan duhet të përcillet dhe në fund të vlerësohet.

Mësimi 4

Kuizi për të drejtat e njeriut

Çka është e drejtë? Cila duhet të jetë e drejtë e njeriut?

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësit mësojnë për të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit përgjigjen në pyetjet me alternativa të shumta të përgjigjes dhe diskutojnë për implikimet e përgjigjeve të tyre.
Burimet	Skeda për çdo nxënës, me zgjedhjet në anën e prapme (shih prospektet për nxënës 5.5).
Metoda	Pyetje me zgjidhje të shumfishta.

Kuti informacioni

Edhe pse të drejtat e njeriut është një koncept dinamik, dhe kështu një koncept i cili vazhdimisht po evoluon, e drejta ndërkombëtare përcakton përmbajtjen dhe shtrirjen e të drejtave të njeriut. Kuizi mbi të drejtat e njeriut i cili pason, që nuk duhet të përdoret si test i njohurive, ndihmon për t'u treguar nxënësve se në cilën fazë gjendemi tani në zhvillimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu ndihmon në shmangien e keqinterpretimeve të kornizës mbi të drejtat e njeriut.

Para këtij mësimi, mësimdhënësi duhet të shënojë të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me marrëveshjet e bëra brenda KB-së apo Këshillit të Evropës. Mund të jetë gjithashtu e dobishme që të fillohet me një shpjegim të shkurtër të termave ose koncepteve të përdorura, siç është KB-ja, Këshilli i Evropës (që të mos ngatërrohet me Këshillin Evropian në Bashkimin Evropian), të drejtat e njeriut, kombi/shteti, diskriminimi, gjyqtari ose procesi gjyqësor.

Mësimi

Së pari, mësimdhënësi shpjegon se qëllimi i kuizit nuk është që të testohet njohuria e tyre, por të lartësohet kuptimi i të drejtave të njeriut në mënyrë aktive.

Nxënësit vetë i përgatisin skedat duke prerë shiritat e letrës me pyetjet dhe përgjigjet. Ata pastaj i ngjisin shpinë për shpinë në mënyrë që pyetjet dhe përgjigjet t'i kenë në skedën e njëjtë.

Në grupe të vogla (ose në çifte) nxënësit tani ulen së bashku dhe i shtrojnë pyetje njëri tjetrit. Më pas, çdo grupi të nxënësve u jepet grupi i skedave. Çdo pyetje ka tri përgjigje të mundshme, domethënë A, B ose C. Nxënësit zgjedhin atë çka ata besojnë se është përgjigje e saktë për çdo pyetje. Duhet theksuar se ndonjëherë është e mundur të jetë më shumë se një përgjigje e saktë, meqë të drejtat e njeriut janë koncept dinamik që evoluon vazhdimisht, dhe kjo lë hapësirë për interpretim.

Është mirë që ndonjëherë përgjigjet të diskutohen në klasë. Në këtë mënyrë, mësimi nuk do të bëhet një kuiz me pyetje dhe përgjigje i bazuar thjeshtë në njohuritë. Por është me rëndësi që të jemi të gatshëm për diskutim në publik duke e përgatitur edhe elementin e diturisë.

Pyetjet dhe përgjigjet

Shih gjithashtu prospektet për nxënës 5.5. Mësimdhënësi apo një grup i nxënësve përgatit grupe të mjaftueshme të skedave, duke prerë shiritat e gjatë të letrës me pyetjet dhe përgjigjet, duke i palosur ato dhe ngjitur së bashku.

<p>Puna e kryer nga fëmijët që kanë mbushur moshën 17 vjeçare:</p> <p>A. Gjithmonë është shkelje e të drejtave të fëmijës. B. Është shkelje e të drejtave të fëmijës nëse puna e lëndon atë. C. Mund të jetë e pranueshme nëse qeveria ka caktuar moshën minimale të punës të jetë nën 17 vjeç.</p>	<p>Puna e kryer nga fëmijët që kanë mbushur moshën 17 vjeçare:</p> <p>C është e saktë. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve ndalon punën e kryer nga fëmija nëse ajo është e rrezikshme apo është formë e eksploatimit, por lejon qeveritë që të caktojnë moshën sipas të cilës ndalesa do të jetë e vlefshme. Po bëhet shumë presion për të arritur kufizime më të ashpra për punën e kryer nga fëmijët.</p>
<p>Sipas marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të ujit:</p> <p>A. Qeveritë janë të obliguara që qytetarëve të tyre t'u sigurojnë ujë të pastër dhe të shëndetshëm. B. Qeverive nuk u lejonet të bëjnë diskriminim kundër disa qytetarëve në sigurimin e ujit. C. Qeverive nuk u lejonet t'u mohojnë qytetarëve qasjen në furnizimin me ujë.</p>	<p>Sipas marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të ujit:</p> <p>Sipas interpretimit të Komitetit të KB-së mbi të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, B dhe C janë të sakta, A nuk është e saktë. Plotësimi i të drejtës për ujë është diçka për të cilën qeveritë duhet të luftojnë, por kjo e drejtë nuk mund të kërkohet si e tillë nga qytetarët.</p>
<p>Dënimi me vdekje:</p> <p>A. Në përgjithësi është ndaluar në tërë botën. B. Është hequr me ligj ose në praktikë nga më shumë se 50% e të gjitha shteteve. C. Nuk lejohet në rastin e të rinjve nën moshën 18 vjeçare.</p>	<p>Dënimi me vdekje:</p> <p>B dhe C janë të sakta, A nuk është e saktë. Dënimi me vdekje nuk është tërësisht i ndaluar me traktatet e KB-së, as me KEDNJ, edhe pse në të dyja rastet është ndaluar me një protokoll opcional. Protokollin 6 (heqja e dënimit me vdekje në kohë të paqes) dhe Protokollin 13 (heqja e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat) i KEDNJ janë nënshkruar të dy dhe/ose ratifikuar nga shumë shtete.</p>
<p>Të drejtat ekonomike dhe sociale:</p> <p>A. Nuk janë të drejta të patundshme të njeriut. B. Nga shtetet nuk pritët plotësimi i menjëhershëm i këtyre të drejtave për të gjithë individët. C. Këto të drejta mund të kërkohen nga çdo individ i cili është evropian.</p>	<p>Të drejtat ekonomike dhe sociale:</p> <p>B është e saktë. Zyrtarisht, të drejtat ekonomike dhe sociale janë të drejta të patundshme të njeriut, edhe pse është e vërtetë se, obligimi për t'i njohur ato është shumë më i brishtë se për shumicën e të drejtave civile dhe politike. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nga shtetet pret që ata të bëjnë përpjekje për plotësimin e këtyre të drejtave, por nuk ka mekanizëm evropian që individëve do t'u mundësonte të paraqesin ankesë (edhe pse sipas disa kufizimeve të caktuara, një protokoll shtesë lejon organizatat që këtë ta bëjnë).</p>

<p>Sipas dispozitave të të drejtës për edukim:</p> <p>A. Individëve dhe grupeve u lejohe të hapin një shkollë, me kusht që ata të plotësojnë kushtet minimale ligjore.</p> <p>B. Nuk ka obligime për sa i përket përmbajtjes së programeve edukative.</p> <p>C. Qeveritë janë të obliguara të sigurojnë edukim të detyrueshëm për të gjithë të rinjtë nën moshën 18 vjeçare.</p>	<p>Sipas dispozitave të të drejtës për edukim:</p> <p>A është e saktë, B dhe C nuk janë. Konventat ndërkombëtare, siç është Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve parashohin që, përmes edukimit fëmijët duhet të informohen për të drejtat e njeriut.</p>
<p>E drejta për t'u pranuar si refugjat:</p> <p>A. Është përcaktuar për njerëzit të cilët kanë frikë të bazuar se do të ndiqen në bazë të racës së tyre, religjionit ose mendimit politik, dhe si pasojë kanë ikur nga vendi i tyre.</p> <p>B. Gjithashtu ekziston për njerëzit të cilët kanë ikur nga shteti i tyre si pasojë e luftës civile ose urisë.</p> <p>C. Një qeveri, automatikisht mund t'ua refuzojë të gjithë aplikantëve dhënien e këtij statusi, të cilët vijnë nga një shtet që konsiderohet të jetë i sigurt.</p>	<p>E drejta për t'u pranuar si refugjat:</p> <p>A është e saktë, B nuk është (edhe pse në disa shtete, njerëzve të cilët ikin nga shteti i tyre si pasojë e luftës civile ose urisë, u ofrohet mbrojtje pa u konsideruar si refugjat sipas konventave ndërkombëtare). C Nuk zbatohet për refugjatët sipas Konventës së Gjenevës, por ka zbatim të gjerë brenda BE-së në trajtimin e azilkërkuësve.</p>
<p>Liria e religjionit:</p> <p>A. Nuk mund t'u mohohet njerëzve nga arsyeja se i përkasin një religjioni minoritar.</p> <p>B. Obligon shtetet të njohin dhe subvencionojnë religjionet.</p> <p>C. Në asnjë mënyrë nuk mund të kufizohet nga shteti.</p>	<p>Liria e religjionit:</p> <p>A është e saktë. Shtetet janë të obliguara të respektojnë lirinë e religjionit, por nuk kanë obligim ligjor për ndonjë sistem të njohjes apo subvencionimit. Shtetet mund të kufizojnë lirinë e religjionit, për shembull, kur religjioni do të ishte në kundërshtim me të drejtat fundamentale të njeriut.</p>
<p>E drejta në pronësi:</p> <p>A. Nuk do të thotë se qeveritë nuk mund të marrin pronën nga dikush nëse kjo është në interesin publik.</p> <p>B. Është shkelur nëse një fshat i tërë evakuohet pa kompensim të duhur për të ndërtuar një hidroelektranë.</p> <p>C. Lejon personin që mallrat e vjedhura t'i konsiderojë si pronë të tij.</p>	<p>E drejta në pronësi:</p> <p>A dhe B janë të sakta. C me sa duket është gabim.</p>
<p>Zgjedhjet:</p> <p>A. Të gjithë qytetarëve u lejohe të votojnë, edhe nëse ata i kanë humbur të drejtat e tyre civile për shkak të aktivitetit kriminal.</p> <p>B. Nëse votuesi është punëdhënës, lejohen dy vota për çdo person.</p> <p>C. Votimi duhet të bëhet në mënyrë të fshehtë.</p>	<p>Zgjedhjet:</p> <p>Vetëm C është e saktë. Një shtet mund të ndalojë personin, i cili ka humbur të drejtat e tij civile, të votojë. Të drejtat e barabarta për secilin që ka të drejtë vote është normë ndërkombëtare.</p>
<p>Liria e shprehjes:</p> <p>A. Mund të kufizohet për t'u mbrojtur kundër shpifjes.</p> <p>B. Nuk mund të kufizohet për arsye të moralit publik.</p> <p>C. Mund të kufizohet për të ndaluar mostolerancën religjioze.</p>	<p>Liria e shprehjes:</p> <p>A dhe C janë të sakta. Liria e shprehjes, nën kushte të caktuara, mund të kufizohet për arsye të moralit publik, për parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose për mbrojtjen kundër shpifjes, nëse kjo është e paraparë me ligj.</p>
<p>E drejta për të punuar:</p> <p>A. Obligon shtetet që të sigurojnë punë për të gjithë qytetarët e tyre.</p> <p>B. Do të thotë se askush nuk mund të pushohet nga puna në mënyrë arbitrare.</p> <p>C. Nuk do të thotë se qeveria duhet bërë përpjekje të realizojë punësim të plotë.</p>	<p>E drejta për të punuar:</p> <p>Vetëm B është e saktë. Në Evropë, shtetet obligohen të bëjnë përpjekje të realizojnë punësim të plotë, por kjo nuk është e përfshirë në traktatet e KB-së.</p>

<p>E drejta për ambient të shëndetshëm:</p> <p>A. Ndalon shtetet të hedhin plehra toksike që e dëmtojnë tokën në mënyrë të pakthyeshme.</p> <p>B. Synon të mbrojë qeniet njerëzore, kafshët dhe bimët.</p> <p>C. Akoma nuk është vendosur si e drejtë universale.</p>	<p>E drejta për ambient të shëndetshëm:</p> <p>C është e saktë, edhe pse e drejta për shëndet mbrohet njerëzit nga dëmet që janë pasojë e drejtpërdrejtë e ndotjes. Në këto raste, në të gjithë botën janë të mbrojtur vetëm qeniet njerëzore, kafshët dhe bimët nuk janë. Karta e Afrikës dhe Karta e Bashkimit Evropian, të cilat nuk janë të vlefshme në të gjithë botën, vendosin deri në një shkallë të caktuar të drejtën për ambient të shëndetshëm.</p>
<p>Sipas të drejtës për edukim:</p> <p>A. Fëmijët e ciklit fillor nuk duhet të ngarkohen me pagesa shkollore, mund të kërkohen vetëm shpenzimet e ekskursioneve dhe teksteve shkollore.</p> <p>B. Është obligim i shtetit që të bëjë përpjekje të ndihmojë sa më shumë nxënës që të jetë e mundur të kenë sukses në mësimet e tyre.</p> <p>C. Shtetet duhet t'u ofrojnë të gjithë nxënësve mundësi të barabarta në edukim.</p>	<p>Sipas të drejtës për edukim:</p> <p>B dhe C janë të sakta (këto obligime janë të përfshira në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve). Në parim, edukimi fillor duhet të jetë falas, dhe kjo nuk përfshin vetëm pagesën e shkollës, por edhe shpenzime të tjera indirekte që kanë të bëjnë me aktivitetet themelore shkollore.</p>
<p>Ndëshkimi i fëmijëve në shkollë:</p> <p>A. Nuk lejohet në formë të ndëshkimit trupor.</p> <p>B. Nuk ndalohet nëse ndëshkimi është mendërisht mizor.</p> <p>C. Mund të përdoret vetëm me pëlqimin e prindërve.</p>	<p>Ndëshkimi i fëmijëve në shkollë:</p> <p>A konsiderohet të jetë e saktë, meqë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ndëshkimin trupor vazhdimisht e ka konsideruar si shkelje të KEDNJ (dhe kjo përputhet me interpretimin që është dhënë nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve për Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve). B është e pasaktë, meqë ndalesa ka të bëjë me të gjitha ndëshkimet mizore. Sa i përket C-së, nuk ka dispozitë që ndëshkimin e bën drejtpërdrejt të varur nga pëlqimi i prindërve.</p>
<p>Në shkollë:</p> <p>A. Nuk duhet kushtuar vëmendje çështjeve ambientale.</p> <p>B. Fëmijët e vegjël duhet mësuar të respektojnë prindërit e tyre.</p> <p>C. Fëmijët e vegjël duhet të mësojnë për të drejtat e njeriut dhe të përjetojnë të drejtat e njeriut.</p>	<p>Në shkollë:</p> <p>B dhe C janë të sakta. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve përmban dispozita të tilla. Me Konventë gjithashtu përcaktohet se edukimi duhet të ketë synim respektimin e ambientit.</p>
<p>Në gjykatë:</p> <p>A. Çdo kriminel ka të drejtë në avokat.</p> <p>B. Njerëzit mund të dënohen vetëm nëse kanë pranuar fajin.</p> <p>C. I dyshuari ka të drejtë në përkthyes pa pagesë nëse gjykimi mbahet në një gjuhë të cilën ai nuk e kupton.</p>	<p>Në gjykatë:</p> <p>A dhe C janë të sakta.</p>
<p>Tortura:</p> <p>A. Lejohet nëse përdoret për të parandaluar sulmet terroriste</p> <p>B. Lejohet vetëm me vendim të gjyqtarit.</p> <p>C. Asnjëherë nuk lejohet.</p>	<p>Tortura:</p> <p>C është e saktë (tortura nuk lejohet as në raste të emergjencës shtetërore).</p>
<p>E drejta për jetë është shkelur nëse:</p> <p>A. Dikush vdes aksidentalisht për shkak të forcave policore të cilat parandalojnë një sulm mbi jetën e dikujt tjetër.</p> <p>B. Dikush vdes për shkak të një akti të luftës, edhe nëse ai është i ligjshëm.</p> <p>C. Dikush vdes për shkak të forcës së panevojshme të përdorur nga policia.</p>	<p>E drejta për jetë është shkelur nëse:</p> <p>C është e saktë. Në rastin e A-së, e drejta për jetë mund të shkelet nëse forca e përdorur nga policia tejkalon atë që absolutisht është e nevojshme.</p>

<p>Sipas të drejtës për strehim:</p> <p>A. Të gjitha shtetet obligohen të sigurojnë që askush të mos jetë i pastrehë.</p> <p>B. Të huajve duhet ofruar qasje të njëjtë në banesa shoqërore sikurse qytetarëve të atij shteti.</p> <p>C. Shteti duhet të bëjë përpjekje të zvogëlojë numrin e njerëzve të pastrehë.</p>	<p>Sipas të drejtës për strehim:</p> <p>B dhe C janë të sakta.</p>
<p>Sipas të drejtës për kujdes shëndetësor:</p> <p>A. Qeveritë nuk obligohen të parandalojnë aksidentet në punë.</p> <p>B. Të gjithë duhet të kenë qasje në kujdes shëndetësor.</p> <p>C. Medikamentet duhet të jenë falas.</p>	<p>Sipas të drejtës për kujdes shëndetësor:</p> <p>B është e saktë. Parandalimi i aksidenteve në punë konsiderohet si obligim. Medikamentet mund të shiten.</p>
<p>Sipas të drejtës për liri të lëvizjes:</p> <p>A. Personit mund t'i ndalohe të zgjedhë vendbanimin e caktuar për arsye të sigurisë publike.</p> <p>B. Refuzimi i dhënies së vizës personit i cili nuk ka qenë i dënuar për ndonjë krim është shkelje e të drejtave të njeriut.</p> <p>C. Krimineli mund të burgoset.</p>	<p>Sipas të drejtës për liri të lëvizjes:</p> <p>A dhe C janë të sakta. Dhënia e vizës mund t'i mohohet çdokujt, dhe jo vetëm kriminelëve. Kufizimet e lirisë së lëvizjes mund të shqiptohen edhe për arsye të shëndetit publik, të rendit publik ose të sigurisë shtetërore, nëse parashihet me ligj.</p>

Prospektet për nxënës 5.1
Dëshirat, nevojat dhe të drejtat

Dëshirat	Nevojat themelore	Të drejtat e njeriut

Prospektet për nxënës 5.2

Lista e të drejtave të njeriut

Kjo është një listë e të drejtave të njeriut e përfshirë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe në Kartën e korrigjuar (rishikuar) Evropiane Sociale (KES).

- 1 E drejta për jetë.
- 2 Liria nga tortura.
- 3 Liria nga skllavërimi.
- 4 E drejta për liri dhe siguri.
- 5 E drejta për gjykim të drejtë.
- 6 E drejta për mjet efektiv nëse shkelet një e drejtë e njeriut.
- 7 Liria nga diskriminimi; e drejta për barazi.
- 8 E drejta për t'u pranuar si person; e drejta për nënshtetësi.
- 9 E drejta për privatësi dhe jetë familjare.
- 10 E drejta për t'u martuar.
- 11 E drejta për posedim të pronës.
- 12 E drejta për lëvizjen e personave.
- 13 E drejta për azil.
- 14 Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit.
- 15 Liria e shprehjes.
- 16 Liria e mbledhjes dhe asociimit (shoqërorizimit).
- 17 E drejta për ushqim, pije dhe strehim.
- 18 E drejta për kujdes shëndetësor.
- 19 E drejta për edukim.
- 20 E drejta për punësim.
- 21 E drejta për pushim dhe kohë të lirë.
- 22 E drejta për mbrojtje shoqërore.
- 23 E drejta për pjesëmarrje politike.
- 24 E drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore.
- 25 Ndalimi i shkatërrimit të të drejtave të njeriut.
- 26 E drejta për rend shoqëror që njeh të drejtat e njeriut.
- 27 Përgjegjësitë dhe detyrat e individit.

Prospektet për nxënës 5.3**Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut**

Cenimi apo shkelja e të drejtave të njeriut	E drejta e njeriut
a. Znj. X, e cila para ca vitesh e humbi vajzën dhe burrin e saj në një aksident automobilistik, nuk mund të martohej me burrë tjetër pa dhënë leje të qartë kunati i saj.	
b. Rojet e burgut i përdorën qentë për të frikësuar dhe kërcënuar të burgosurit me sulme, dhe në një rast ata detyruan qentë të kafshojnë një të burgosur.	
c. Në një fabrikë lokale, punëtorët duhet të punojnë për së paku 10 orë në ditë pa pushim.	
d. Që nga arrestimi i tyre, tre burra kanë pasur probleme për qasje në avokat. Avokatët kishin ardhur shumë herë por atyre nuk u ishte lejuar që t'i shohin këtë të arrestuar; burrave nuk u lejohej që të zhvillojnë diskutime të përbashkëta me avokatët e tyre, që në të vërtetë do të thoshte se dy prej tyre nuk kishin qasje në avokatët e tyre.	
e. Një grua, e cila e kryen saktësisht punën e njëjtë dhe e ka moshën dhe përvojën e njëjtë sikurse kolegu i saj mashkull, ka marrë pagë më të ulët se ai.	
f. X e rrëmbeu dhe e arrestoi Y për tri ditë dhe e gjuajti atë në kokë, gjë që pasoi me vdekjen e tij pas 3 ditësh.	
g. Znj. X, e varur nga droga, ishte fotografuar kur ajo po largohej nga një takim anonim i narkotikëve. Më vonë kjo fotografi ishte publikuar.	
h. Një grua, e keqtrajtuar nga burri i saj, kishte mundur të shkurorëzohet atëherë kur atij i kishte dhënë shtëpinë, veturën dhe tërë pasurinë e saj. Asaj nuk i kishte mbetur asgjë.	
i. X, e cila vuante nga pneumonia me rrezik për jetën, nuk i kishin ofruar trajtim mjekësor në spital, meqë ajo kishte hyrë ilegalisht në këtë shtet.	
j. Shtatëdhjetë për qind e popullatës në zonën X ishin detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, dhe më vonë i kishin penguar që të kthehen. Atyre nuk u lejohej të largohen nga kampet e tyre për të shkuar në fushat e afërta për të kultivuar të mbjellat e tyre, dhe u ndalohej udhëtimi nëpër shumë rrugë.	
k. Afrikanët e zi i blinin në Afrikë, për shembull, për një shishe uiski, dhe shiteshin në Amerikën Veriore ndërmjet 1 200 dhe 1 500 dollarë amerikan.	
l. Në shtetin X, të gjitha mjetet e jetesës për popullatën vendore qëllimisht janë shkatërruar: të mbjellat, furnizimi me ujë dhe bagëtia.	
m. Në shtetin X, qytetarët mund të burgosen pa u akuzuar.	
n. Një reporter 26-vjeçar i një gazete ditore, ishte qëlluar për vdekje në një sulm të dyshimtë raprezaliesh, për mbulimin e fushatës zgjedhore të posa përfunduar.	
o. Z. X ishte thirrur për t'u regjistruar në ushtri. Ai i shkroi zyrës ushtarake duke deklaruar kundërshtimin e tij të ndërgjegjshëm për shërbimin ushtarak dhe refuzoi të paraqitet për shërbim ushtarak. Ai ishte akuzuar për mosbindje dhe ia kishin ndaluar që të largohet nga vendi.	
p. Në shtetin X, ata të cilët duan t'i përkasin religjionit Falun Gong janë të ndaluar që të mblidhen.	
q. Shumica etnike urdhëroi që, ata të cilët u përkasin grupeve minoritare, siç janë populli çifut dhe rom, obligohen të jetojnë në zona të caktuara të qytetit.	

Cenimi apo shkelja e të drejtave të njeriut	E drejta e njeriut
r. Fëmijët të cilët jetojnë në fshat nuk kanë mundësi të vijojnë shkollën fillore, meqë një shkollë e tillë nuk është në dispozicion brenda një distance të arsyeshme.	
s. X nuk mund të vë kandidaturën për zgjedhjet parlamentare, sepse autoritetet religjioze të shtetit nuk e kanë pranuar atë.	
t. Duke qenë i zi, X nuk mund të punësohet si mjek në spitalin lokal.	
u. Në disa shtete njerëzit e varfër nuk kanë qasje në programe të ushqimit apo të strehimit, as në shërbime shëndetësore të përballueshme për ata.	
v. Z. X, shtëpia e të cilit është djegur, nuk mund të paraqiste kërkesë për kompensim.	
w. X, një grua 47 vjeçare, e cila gjithmonë ka punuar në shtëpi si amvise dhe nënë e pesë fëmijëve, i humb të gjitha përfitimet nga sigurimi social pasi shkurorezohet nga burri i saj.	
x. Z. X, baba i dy fëmijëve, ishte burgosur dhe torturuar në shtetin X për shkrimin e poemave me të cilat kritikoi regjimin në pushtet. Kërkesa e tij për azil politik në shtetin A ishte hedhur poshtë. Ai tha se do të përballej me tortura po të kthehej në vendlindje, meqë ai tani është i obliguar që të kthehet.	
y. Për të ashtuquajturat arsye praktike, njerëzit e paaftë fizikisht, siç janë shfrytëzuesit e karrocës për invalidë, nuk lejohen të marrin pjesë në ngjarje kulturore në teatrin lokal.	
z. Për të aplikuar për nënshtetësi në shtetin X, kërkohet banim për një periudhë 15 vjeçare, një test i shëndetit fizik dhe mental, si dhe taksa administrative pa arsye e lartë. Si pasojë e kësaj, me mijëra rom, të cilët kanë lidhje të vjetra me vendin e tyre, janë pa shtetësi në shtetin e tyre.	

Prospektet e nxënësve 5.4**Të drejtat dh përgjegjësitë**

E drejta e njeriut	Përgjegjësia e individit	Përgjegjësia e shkollës, e autoritetit, etj.

Prospektet për nxënës 5.5

Kuiz mbi të drejtat e njeriut (skeda trajnimi)

<p>Puna e kryer nga fëmijët që kanë mbushur moshën 17 vjeçare:</p> <p>A. Gjithmonë është shkelje e të drejtave të fëmijës. B. Është shkelje e të drejtave të fëmijës nëse puna e lëndon atë. C. Mund të jetë e pranueshme nëse qeveria ka caktuar moshën minimale të punës të jetë nën 17 vjeç.</p>	<p>Puna e kryer nga fëmijët që kanë mbushur moshën 17 vjeçare:</p> <p>C është e saktë. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve ndalon punën e kryer nga fëmija nëse ajo është e rrezikshme apo është formë e eksploatimit, por lejon qeveritë që të caktojnë moshën sipas të cilës ndalesa do të jetë e vlefshme. Po bëhet shumë presion për të arritur kufizime më të ashpra për punën e kryer nga fëmija.</p>
<p>Sipas marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të ujit:</p> <p>A. Qeveritë janë të obliguara qytetarëve të tyre t'u sigurojnë ujë të pastër dhe të shëndetshëm. B. Qeverive nuk u lejohet të bëjnë diskriminim kundër disa qytetarëve në sigurimin e ujit. C. Qeverive nuk u lejohet t'u mohojnë qytetarëve qasjen në furnizimin me ujë.</p>	<p>Sipas marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të ujit:</p> <p>Sipas interpretimit të Komitetit të KB-së mbi të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, B dhe C janë të sakta, A nuk është e saktë. Plotësimi i të drejtës për ujë është diçka për të cilën qeveritë duhet të luftojnë, por kjo e drejtë nuk mund të kërkohej si e tillë nga qytetarët.</p>
<p>Dënimi me vdekje:</p> <p>A. Në përgjithësi është ndaluar në tërë botën. B. Është hequr me ligj ose në praktikë nga më shumë se 50% e të gjitha shteteve. C. Nuk lejohet në rastin e të rinjve nën moshën 18 vjeçare.</p>	<p>Dënimi me vdekje:</p> <p>B dhe C janë të sakta, A nuk është e saktë. Dënimi me vdekje nuk është tërësisht i ndaluar me traktatet e KB-së, as me KEDNJ, edhe pse në të dyja rastet është ndaluar me një protokoll opcional. Protokollin 6 (heqja e dënimit me vdekje në kohë të paqes) dhe Protokollin 13 (heqja e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat) i KEDNJ janë nënshkruar të dy dhe/ose ratifikuar nga shumë shtete.</p>
<p>Të drejtat ekonomike dhe sociale:</p> <p>A. Nuk janë të drejta të patundshme të njeriut. B. Nga shtetet nuk pritet plotësimi i menjëhershëm i këtyre të drejtave për të gjithë individët. C. Këto të drejta mund të kërkohej nga çdo individ i cili është evropian.</p>	<p>Të drejtat ekonomike dhe sociale:</p> <p>B është e saktë. Zyrtarisht, të drejtat ekonomike dhe sociale janë të drejta të patundshme të njeriut, edhe pse është e vërtetë se, obligimi për t'i njohur ato është shumë më i brishtë se për shumicën e të drejtave civile dhe politike. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nga shtetet pret që ata të bëjnë përpjekje për plotësimin e këtyre të drejtave, por nuk ka mekanizëm evropian që individëve do t'u mundësonte të paraqesin ankesë (edhe pse sipas disa kufizimeve të caktuara, një protokoll shtesë lejon organizatat që këtë ta bëjnë).</p>
<p>Sipas dispozitave të të drejtës për edukim:</p> <p>A. Individëve dhe grupeve u lejohet të hapin një shkollë, me kusht që ata të plotësojnë kushtet minimale ligjore. B. Nuk ka obligime për sa i përket përmbajtjes së programeve edukative. C. Qeveritë janë të obliguara të sigurojnë edukim të detyrueshëm për të gjithë të rinjtë nën moshën 18 vjeçare.</p>	<p>Sipas dispozitave të të drejtës për edukim:</p> <p>A është e saktë, B dhe C nuk janë. Konventat ndërkombëtare, siç është Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve parashohin që përmes edukimit fëmijët duhet të informohen për të drejtat e njeriut.</p>
<p>E drejta për t'u pranuar si refugjat:</p> <p>A. Është përcaktuar për njerëzit të cilët kanë frikë të bazuar se do të ndiqen në bazë të racës së tyre, religjionit ose mendimit politik, dhe si pasojë kanë ikur nga vendi i tyre. B. Gjithashtu ekziston për njerëzit të cilët kanë ikur nga shteti i tyre si pasojë e luftës civile ose urisë. C. Një qeveri, automatikisht mund t'ua refuzojë të gjithë aplikantëve dhënien e këtij statusi, të cilët vijnë nga një shtet që konsiderohet të jetë i sigurt.</p>	<p>E drejta për t'u pranuar si refugjat:</p> <p>A është e saktë, B nuk është (edhe pse në disa shtete, njerëzve të cilët ikin nga shteti i tyre si pasojë e luftës civile ose urisë u ofrohet mbrojtje, pa u konsideruar si refugjat sipas konventave ndërkombëtare). C Nuk zbatohet për refugjatët sipas Konventës së Gjenevës, por ka zbatim të gjerë brenda BE-së në trajtimin e azilkërkuësve.</p>

<p>Liria e religjionit:</p> <p>A. Nuk mund t'u mohohet njerëzve nga arsyeja se i përkasin një religjioni minoritar.</p> <p>B. Obligon shtetet të njohin dhe subvencionojnë religjionet.</p> <p>C. Në asnjë mënyrë nuk mund të kufizohet nga shteti.</p>	<p>Liria e religjionit:</p> <p>A është e saktë. Shtetet janë të obliguara të respektojnë lirinë e religjionit, por nuk kanë obligim ligjor për ndonjë sistem të njohjes apo subvencionimit. Shtetet mund të kufizojnë lirinë e religjionit, për shembull, kur religjioni do të ishte në kundërshtim me të drejtat fundamentale të njeriut.</p>
<p>E drejta në pronësi:</p> <p>A. Nuk do të thotë se qeveritë nuk mund të marrin pronën nga dikush nëse kjo është në interesin publik.</p> <p>B. Është shkelur nëse një fshat i tërë evakuohet pa kompensim të duhur për të ndërtuar një hidroelektranë.</p> <p>C. Lejon personin që mallrat e vjedhura t'i konsiderojë si pronë të tij.</p>	<p>E drejta në pronësi:</p> <p>A dhe B janë të sakta. C me sa duket është gabim.</p>
<p>Zgjedhjet:</p> <p>A. Të gjithë qytetarëve u lejohet të votojnë, edhe nëse ata i kanë humbur të drejtat e tyre civile për shkak të aktivitetit kriminal.</p> <p>B. Nëse votuesi është punëdhënës, lejohen dy vota për çdo person.</p> <p>C. Votimi duhet të bëhet në mënyrë të fshehtë.</p>	<p>Zgjedhjet:</p> <p>Vetëm C është e saktë. Një shtet mund të ndalojë personin, i cili ka humbur të drejtat e tij civile, të votojë. Të drejtat e barabarta për secilin që ka të drejtë vote është normë ndërkombëtare.</p>
<p>Liria e shprehjes:</p> <p>A. Mund të kufizohet për t'u mbrojtur kundër shpifjes.</p> <p>B. Nuk mund të kufizohet për arsye të moralit publik.</p> <p>C. Mund të kufizohet për të ndaluar mostolerancën religjioze.</p>	<p>Liria e shprehjes:</p> <p>A dhe C janë të sakta. Liria e shprehjes, nën kushte të caktuara, mund të kufizohet për arsye të moralit publik, për parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose për mbrojtjen kundër shpifjes, nëse kjo është e paraparë me ligj.</p>
<p>E drejta për të punuar:</p> <p>A. Obligon shtetet që të sigurojnë punë për të gjithë qytetarët e tyre.</p> <p>B. Do të thotë se askush nuk mund të pushohet nga puna në mënyrë arbitrare.</p> <p>C. Nuk do të thotë se qeveria duhet bërë përpjekje të realizojë punësim të plotë.</p>	<p>E drejta për të punuar:</p> <p>Vetëm B është e saktë. Në Evropë, shtetet obligohen të bëjnë përpjekje të realizojnë punësim të plotë, por kjo nuk është e përfshirë në traktatet e KB-së.</p>
<p>E drejta për ambient të shëndetshëm:</p> <p>A. Ndalon shtetet të hedhin plehra toksike që e dëmtojnë tokën në mënyrë të pakthyeshme.</p> <p>B. Synon të mbrojë qeniet njerëzore, kafshët dhe bimët.</p> <p>C. Akoma nuk është vendosur si e drejtë universale.</p>	<p>E drejta për ambient të shëndetshëm:</p> <p>C është e saktë, edhe pse e drejta për shëndet mbrohet njerëzit nga dëmet që janë pasojë e drejtpërdrejtë e ndotjes. Në këto raste, në të gjithë botën janë të mbrojtur vetëm qeniet njerëzore, kafshët dhe bimët nuk janë. Karta e Afrikës dhe Karta e Bashkimit Evropian, të cilat nuk janë të vlefshme në të gjithë botën, vendosin deri në një shkallë të caktuar të drejtën për ambient të shëndetshëm.</p>
<p>Sipas të drejtës për edukim:</p> <p>A. Fëmijët e ciklit fillor nuk duhet të ngarkohen me pagesa shkollore, mund të kërkohen vetëm shpenzimet e ekskursioneve dhe teksteve shkollore.</p> <p>B. Është obligim i shtetit që të bëjë përpjekje të ndihmojë sa më shumë nxënës që të jetë e mundur të kenë sukses në mësimet e tyre.</p> <p>C. Shtetet duhet t'u ofrojnë të gjithë nxënësve mundësi të barabarta në edukim.</p>	<p>Sipas të drejtës për edukim:</p> <p>B dhe C janë të sakta (këto obligime janë të përfshira në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve). Në parim, edukimi fillor duhet të jetë falas, dhe kjo nuk përfshin vetëm pagesën e shkollës, por edhe shpenzime të tjera indirekte që kanë të bëjnë me aktivitetet themelore shkollore.</p>

<p>Ndëshkimi i fëmijëve në shkollë: A. Nuk lejohet në formë të ndëshkimit trupor. B. Nuk ndalohet nëse ndëshkimi është mendërisht mizor. C. Mund të përdoret vetëm me pëlqimin e prindërve.</p>	<p>Ndëshkimi i fëmijëve në shkollë: A konsiderohet të jetë e saktë, meqë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ndëshkimin trupor vazhdimisht e ka konsideruar si shkelje të KEDNJ (dhe kjo përputhet me interpretimin që është dhënë nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve për Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve). B është e pasaktë, meqë ndalesa ka të bëjë me të gjitha ndëshkimet mizore. Sa i përket C-së, nuk ka dispozitë që ndëshkimin e bën drejtpërdrejt të varur nga pëlqimi i prindërve.</p>
<p>Në shkollë: A. Nuk duhet kushtuar vëmendje çështjeve ambientale. B. Fëmijët e vegjël duhet mësuar të respektojnë prindërit e tyre. C. Fëmijët e vegjël duhet të mësojnë për të drejtat e njeriut dhe të përjetojnë të drejtat e njeriut.</p>	<p>Në shkollë: B dhe C janë të sakta. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve përmban dispozita të tilla. Me Konventë gjithashtu përcaktohet se edukimi duhet të ketë synim respektimin e ambientit.</p>
<p>Në gjykatë: A. Çdo kriminel ka të drejtë në avokat. B. Njerëzit mund të dënohen vetëm nëse kanë pranuar fajin. C. I dyshuari ka të drejtë në përkthyes pa pagesë nëse gjykimi mbahet në një gjuhë të cilën ai nuk e kupton.</p>	<p>Në gjykatë: A dhe C janë të sakta.</p>
<p>Tortura: A. Lejohet nëse përdoret për të parandaluar sulmet terroriste B. Lejohet vetëm me vendim të gjyqtarit. C. Asnjëherë nuk lejohet.</p>	<p>Tortura: C është e saktë (tortura nuk lejohet as në raste të emergjencës shtetërore).</p>
<p>E drejta për jetë është shkelur nëse: A. Dikush vdes aksidentalisht për shkak të forcave policore të cilat parandalojnë një sulm mbi jetën e dikujt tjetër. B. Dikush vdes për shkak të një akti të luftës, edhe nëse ai është i ligjshëm. C. Dikush vdes për shkak të forcës së panevojshme të përdorur nga policia.</p>	<p>E drejta për jetë është shkelur nëse: C është e saktë. Në rastin e A-së, e drejta për jetë mund të shkelet nëse forca e përdorur nga policia tejkalon atë që absolutisht është e nevojshme.</p>
<p>Sipas të drejtës për strehim: A. Të gjitha shtetet obligohen të sigurojnë që askush të mos jetë i pastrehë. B. Të huajve duhet ofruar qasje të njëjtë në banesa shoqërore sikurse qytetarëve të atij shteti. C. Shteti duhet të bëjë përpjekje të zvogëlojë numrin e njerëzve të pastrehë.</p>	<p>Sipas të drejtës për strehim: B dhe C janë të sakta.</p>
<p>Sipas të drejtës për kujdes shëndetësor: A. Qeveritë nuk obligohen të parandalojnë aksidentet në punë. B. Të gjithë duhet të kenë qasje në kujdes shëndetësor. C. Medikamentet duhet të jenë falas.</p>	<p>Sipas të drejtës për kujdes shëndetësor: B është e saktë. Parandalimi i aksidenteve në punë konsiderohet si obligim. Medikamentet mund të shiten.</p>
<p>Sipas të drejtës për liri të lëvizjes: A. Personit mund t'i ndalohet të zgjedhë vendbanimin e caktuar për arsye të sigurisë publike. B. Refuzimi i dhënies së vizës personit i cili nuk ka qenë i dënuar për ndonjë krim është shkelje e të drejtave të njeriut. C. Krimineli mund të burgoset.</p>	<p>Sipas të drejtës për liri të lëvizjes: A dhe C janë të sakta. Dhënia e vizës mund t'i mohohet çdokujt, dhe jo vetëm kriminelëve. Kufizimet e lirisë së lëvizjes mund të shqiptohen edhe për arsye të shëndetit publik, të rendit publik ose të sigurisë shtetërore, nëse parashihet me ligj.</p>

Fleta e burimeve të mësimdhënësit

Kjo listë përfshin të drejtat nga “Lista e të drejtave të njeriut”, duke treguar nenet relevante nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Karta e korrigjuar (rishikuar) Evropiane Sociale (KES). Ky vështrim i përgjithshëm është bërë për arsye edukative.

	DUDNJ	KEDNJ	KES	KNDCP	ISESCR
1. E drejta për jetë.	3	2		6	
2. Liria nga tortura.	5	3	26	7, 10	
3. Liria nga skllavërimi.	4	4		8	
4. E drejta për liri dhe siguri.	3	5		9	
5. E drejta për gjykim të drejtë.	10, 11	6, 7		14, 15	
6. E drejta për mjet efektiv nëse shkelet një e drejtë e njeriut.	8	13	D	2, 9	
7. Liria nga diskriminimi; e drejta për barazi.	2, 7	14	4, 15, 20, 27, E	3, 26	3
8. E drejta për t’u pranuar si person; e drejta për nënshtetësi.	6, 15			16, 24	
9. E drejta për privatësi dhe jetë familjare.	12	8		17	
10. E drejta për t’u martuar.	16	12		23	
11. E drejta për posedim të pronës.	17				15
12. E drejta për lëvizjen e personave.	13		18	12	
13. E drejta për azil.	14			18	
14. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit.	18	9		18	
15. Liria e shprehjes.	19	10	28	19	8
16. Liria e mbledhjes dhe asociimit (shoqërorizimit).	20	11	5, 28	21, 22	8
17. E drejta për ushqim, pije dhe strehim.	25		30, 31		11
18. E drejta për kujdes shëndetësor.	25		11		7, 12
19. E drejta për edukim.	26		10		13, 14
20. E drejta për punësim.	23		1, 2, 3, 4, 24		6, 7
21. E drejta për pushim dhe kohë të lirë.	24		2		7
22. E drejta për mbrojtje shoqërore.	22, 25		7, 8, 12, 13, 14, 16, 17, 19, 23, 25		9, 10
23. E drejta për pjesëmarrje politike.	21		22	25	
24. E drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore.	27			27	15
25. Ndalimi i shkatërrimit të të drejtave të njeriut	30	17		5, 20	5
26. E drejta për rend shoqëror që njeh të drejtat e njeriut.	28			2	2
27. Detyrat e individit	29				

Shënim: Disa neneve në KES u referohemi me numra, disave me shkronja të mëdha.

NJËSIA 6: Përgjegjësia

Çfarë përgjegjësish kanë njerëzit?

Përgjegjësia ligjore

Qytetarët e cilitdo shteti kanë të drejtë të dinë se cilat janë të drejtat e tyre sipas ligjit, dhe gjithashtu të çmojnë shtrirjen e përgjegjësive të tyre ligjore që ata i kanë ndaj shtetit dhe ndaj qytetarëve të tjerë. Përgjegjësitë e qytetarëve të shteteve demokratike ndonjëherë përmbledhen në tri detyra kryesore, pra, të votojnë, të paguajnë taksat dhe t'i binden ligjit.

Përgjegjësitë janë shpesh plotësim i të drejtave. Për shembull, e drejta për liri të fjalës sjell me vete përgjegjësinë për t'ua lejuar të njëjtën të drejtë të tjerëve. Mirëpo, njerëzit të cilët kryejnë krime nuk i humbin domosdoshmërisht të drejtat që ata ua mohuan të tjerëve (si në rastin e vrasjes apo diskriminimit). Po ashtu, njerëzit shpesh kanë obligime të cilat nuk janë reciproke, për shembull, përgjegjësitë ndaj fëmijëve.

Përgjegjësia morale

Në EQD është shumë me rëndësi që të rrisim kapacitetin e të rinjve që ata të mendojnë moralisht. Pa këtë kapacitet, nuk mund të ketë vlerësim kritik të ligjeve të shoqërisë apo të strukturave shoqërore nga pikëvështrimi nëse ata janë të drejtë (paanshëm). Për këtë arsye, kur nxënësit t'i mësojmë për ligjet të cilat i dëmtojnë ata, nxënësit duhet gjithashtu inkurajuar që të bëjnë vlerësim kritik të funksionit dhe qëllimit të tyre, dhe nëse ata duhet ndryshuar në çfarëdo mënyre.

Të mësuarit mbi përgjegjësitë

Duke shikuar arsyet pse njerëzit sillen në mënyrën që është në favor të shoqërisë, ose duke theksuar shtrirjen e nevojave të njerëzve të tjerë, mësimdhënësit mund të ndihmojnë nxënësit të bëhen më të vetëdijshëm për nevojat dhe të drejtat e të tjerëve. Gjithashtu është me rëndësi që mësimdhënësit të demonstrojnë sjellje të përgjegjësive para nxënësve.

Nxënësit mësohen të bëhen qytetarë të përgjegjshëm jo vetëm përmes mësimin në klasë, por, gjithashtu, duke u dhënë mundësinë të mësojnë nga përvoja. Në këtë aspekt, shkolla e mirë e EQD-së do të jetë e interesuar të inkurajojë nxënësit të përfshihen në jetën e shkollës dhe në komunitetin më të gjerë, për shembull, përmes këshillave të shkollës.

Në këtë njësi nxënësit do të:

- eksplorojnë vargun e përgjegjësive të përjetuar nga qytetarët në shoqëri;
- eksplorojnë llojin e përgjegjësive ligjore të njerëzve;
- marrin parasysh llojin e ndarë të përgjegjësive shoqërore;
- mendojnë pse njerëzit marrin përgjegjësi personale për të sjellë ndryshime shoqërore

NJËSIA 6: Përgjegjësia

Çfarë përgjegjësish kanë njerëzit?

Titulli i mësimit	Objektivat	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metoda
Mësimi 1: Përgjegjësitë në shtëpi	Të shqyrtohet vargu i përgjegjësive që e kanë njerëzit. Të kuptojmë se përgjegjësitë mund të bien në konflikt njëra me tjetrën.	Nxënësit analizojnë dilemën morale. Nxënësit diskutojnë për analiza alternative. Nxënësit bëjnë paraqitjet e tyre individuale	Kopje të tregimit “Andrea bën një zgjedhje”. Letër për detyra me shkrim.	Diskutim individual dhe në grupe të vogla. Diskutim plenar. Punë individuale me shkrim.
Mësimi 2: Pse njerëzit duhet t’i binden ligjit?	Të shqyrtohet arsyetimi moral që qëndron pas vendimeve lidhur me konfliktet e përgjegjësive.	Nxënësit analizojnë një dilemë morale. Nxënësit vlerësojnë në mënyrë kritike arsyet për bindje ligjore. Nxënësit propozojnë situata në të cilat detyra morale mund të mbizotërojë mbi detyrën për t’ju bindur ligjit.	Kopje të tregimit “Dilema e Schmitt”. Letër për detyra me shkrim. Dërrasa e zezë	Shkëmbim i analizës për dilemën morale. Analizë e mbështetur nga mësimdhënësi. Shkrimi (përpilimi) i tregimeve. Diskutim plenar.
Mësimi 3: Problem i kujt është kjo?	Të shqyrtohet natyra e përgjegjësive ligjore të njerëzve. Të gjendet dallimi në mes të obligimeve morale dhe ligjore	Nxënësit diskutojnë përgjegjësinë për probleme të caktuara shoqërore. Nxënësit plotësojnë një kornizë të të menduarit. Nxënësit përpilojnë përgjigje me shkrim për çështjet e ngritura.	Kopje të “letrës”. Dërrasa e zezë Letër për detyra individuale me shkrim të nxënësve.	Analiza kritike të strukturuar. Analiza në grupe të vogla dhe diskutim. Arritja e konsensusit dhe negociimi. Shënim personal.
Mësimi 4: Pse njerëzit bëhen qytetarë aktivë?	Të shqyrtohet natyra e ndarë e përgjegjësive për probleme shoqërore. Të shqyrtohen arsyet pse njerëzit pranojnë përgjegjësi për vuajtjet e njerëzve të tjerë. Të shqyrtohet roli i OJQ-ve në shoqërinë civile.	Nxënësit punojnë në grupe për të bashkuar një tregim. Nxënësit paraqesin supozimet e tyre mbi arsyet për sjelljen e motivuar nga marrëdhëniet shoqërore. Nxënësit shqyrtojnë rolin e OJQ-ve. Në grupe, nxënësit hulumtojnë punën e një OJQ-je apo të një përkrhësi shoqëror. Në grupe nxënësit paraqesin rezultatet e tyre.	Kopje të shiritave të letrës për Mia Greenwood (prospektet për nxënës 6.4), tanimë të prerë. Burimet për mbështetjen e punës kërkimore të nxënësve. Burime për prezantime në grup, p.sh. fletë të mëdha të letrës, stilografë me ngjyra.	Punë në grupe. Negociimi. Arsyetimi moral. Vlerësimi kritik. Punë kërkimore. Prezentim në grupe.

Mësimi 1

Përgjegjësitë në shtëpi

Njerëzit përballen me konflikte të besnikërisë – si duhet të vendosin ata?

Objektivat e mësimnxënies	Të shqyrtohet vargu i përgjegjësive që i kanë njerëzit. Të kuptojmë se përgjegjësitë mund të bien në konflikt njëra me tjetrën. Të shqyrtohet arsyetimi moral që qëndron pas vendimeve lidhur me konfliktet e përgjegjësive.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit analizojnë dilemën morale. Nxënësit diskutojnë për analiza alternative. Nxënësit përgatisin ekspozime individuale.
Burimet	Kopje të tregimit “Andrea bën një zgjedhje”. Letër për detyra me shkrim.
Metodat	Diskutim individual dhe në grupe të vogla. Diskutim plenar. Punë individuale me shkrim.

Të mësuarit konceptual

Përgjegjësia: Diçka që njerëzit duhet ta bëjnë – përgjegjësitë mund të jenë ligjore, morale ose shoqërore, varësisht se si paraqiten.

Konflikti moral: Konflikti me të cilin përballen njerëzit kur ata duhet të vendosin në mes të dy apo më shumë rrugëve të veprimit.

Përgjegjësia qytetare: Detyrat e njerëzve ndaj komunitetit më të gjerë. Këto përgjegjësi paraqiten sepse anëtarësimi i një komuniteti sjell të drejta si shpërblim për përgjegjësitë.

Mësimi

Mësimdhënësi paraqet idenë se të gjithë kanë përgjegjësi të ndonjë lloji dhe se problemet mund të paraqiten kur njerëzit disa përgjegjësi i vënë mbi të tjerat. Duhet bërë zgjedhje të vështira. Mësimdhënësi i lexon klasës tregimin “Andrea bën një zgjedhje” dhe kërkon nga nxënësit që ata të mendojnë për çështjet vijuese. Disa pyetje mund të diskutohen në çifte para se të përfundohen përgjigjet. Me pyetjet tjera, nxënësit mund të përgatisin shënime para se t’i shkëmbejnë idetë e tyre me klasën, të cilat do të jenë të dobishme.

- 1 Çfarë thuhet në tregim për llojin e përgjegjësive që i ka Andrea? Sa lloje të ndryshme të përgjegjësive mund të shihni ju (përgjegjësia për veten, për familjen e tij, për shkollën, për komunitetin lokal ose për shoqërinë më të gjerë)?
- 2 Çka mendoni ju se duhet të bëjë Andrea dhe pse? A pajtohen të gjithë në klasë?
- 3 Sa mendoni ju se është i vështirë vendimi i Andreas? Çka e bën atë të vështirë?
- 4 Çfarë përgjegjësish ka babai i Andreas në tregim? Sa prej tyre mund t’i shihni ju?
- 5 A mendoni ju se babai i Andreas kishte të drejtë të kërkojë që Andrea të rri në shtëpi?
- 6 Sa e rëndë do të ishte nëse Andrea nuk do t’i bindej babait të tij? A do të ishte vështirë që Andrea të merrte këtë vendim? Jepni arsyet për përgjigjen tuaj.

Detyrë me shkrim

Me fjalët e juaja, shënoni çka ju mendoni se Andrea i shkroi babait të tij. Krahasoni versionin tuaj me ato të të tjerëve në klasë. Nxënësit i shkëmbejnë idetë e tyre me klasën.

Përgjithësim

Ndoshta nxënësit tanimë kanë trajtuar disa aspekte të përgjithshme të konfliktit moral. Mësimdhënësi u përgjigjet këtyre mendimeve apo kërkon nga klasa që të mendojë në mënyrë më të përgjithshme për llojet e përgjegjësive që njerëzit i kanë ndaj:

- vetes;
- familjes së tyre;
- komunitetit të tyre lokal;
- komunitetit vendor;
- shoqërisë më të gjerë.

Nxënësit sërish punojnë në grupe. Ata mund të përdorin një tabelë për të paraqitur përgjegjësitë e ndryshme. Në vazhdim, në klasë diskutohen arsyet pse njerëzit nuk pajtohen për shkallën e përgjegjësive që njerëzit kanë për të tjerët dhe për komunitetin.

Ekspozime individuale

Në vijim mësimdhënësi duhet t’ju jep nxënësve informacionet vijuese. “Në këtë tregim, disa nga përgjegjësitë e Andreas bien në konflikt njëra me tjetrën. Mendoni disa shembuj të juaj ku përgjegjësitë e njerëzve mund të bien në konflikt. Merrni shembuj specifik dhe komentoni si mendoni ju se njerëzit i zgjidhin konfliktet e tilla të përgjegjësive.”

Nëse nxënësit e kanë vështirë të mendojnë për këtë, mësimdhënësi duhet t’u ofrojë disa shembuj specifik, duke u tërhequr nga konteksti lokal.

Mësimi 2

Pse njerëzit duhet t'i binden ligjit?

Cilat janë arsyet themelore për t'ju bindur ligjit?

Objektivat e mësimnxënies	Të shqyrtohet natyra e përgjegjësive ligjore të nxënësve. Të shqyrtohet dallimi në mes të obligimeve morale dhe ligjore.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit analizojnë një dilemë morale në një diskutim plenar. Nxënësit, në mënyrë kritike, vlerësojnë arsyet për bindje ligjore. Nxënësit sugjerojnë situata në të cilat detyrimi moral mund të mos përfill detyrimin për t'ju bindur ligjit
Burimet	Kopje të tregimit “Dilema e Schmitt”. Letër për detyra me shkrim. Dërrasa e zezë.
Metodat	Shkëmbim i analizës për dilemën morale. Analizë e mbështetur nga mësimdhënësi. Përpilimi i tregimeve. Diskutim plenar.

Të mësuarit konceptual

Ligji: Rregull e vendosur nga qeveria lokale apo qendrore.

Sundimi i ligjit: Në shoqëritë demokratike, qeveritë dhe ata që janë në pushtet u nënshtrohen ligjeve të shtetit që janë në fuqi. Ndërrimet e pushtetit kontrollohen në mënyrë demokratike, sipas rregullave të kushtetutës së atij shteti, dhe jo si rezultat i forcës apo luftës. Njerëzit kanë detyrim të përgjithshëm t'i binden ligjit sepse kështu është vendosur në mënyrë demokratike.

Detyrimi ligjor: Obligimet që njerëzit i kanë sipas ligjit.

Përgjegjësia morale: Obligimet personale që njerëzit i ndiejnë bazuar në besimin e tyre se çka është mirë dhe çka është keq.

Mësimi

Mësimdhënësi paraqet tregimin “Dilema e Schmitt” dhe kërkon që nxënësit të punojnë në çifte që të shqyrtojnë nëse Schmitt duhet ta thyej ligjin dhe të vjedhë paratë apo jo. Mësimdhënësi shkruan opinione të ndryshme në dërrasën e zezë nëse Schmitt duhet të vjedhë paratë.

Mësimdhënësi kërkon që nxënësit të zgjedhin një opinion me të cilin ata pajtohen dhe të shtojnë arsyen e tyre me shkrim:

- Schmitt duhet të vjedhë paratë sepse...
- Schmitt nuk duhet të vjedhë paratë sepse...

Mësimdhënësi shkruan vargun e arsyeve të propozuara nga nxënësit në dërrasën e zezë. Për shembull,

“Ai duhet t’i vjedhë paratë sepse jeta e vajzës së tij është më e rëndësishme sesa ligji kundër vjedhjes”;

“Ai nuk duhet t’i vjedhë paratë sepse mund ta zënë”; ose

“Ai nuk duhet të vjedhë sepse është keq të shkelësh ligjin”.

Në vijim diskutohen arsyet e ndryshme në klasë. Pse janë ato të ndryshme? A janë disa arsye më të mira se sa të tjerat? Në vazhdim mësimdhënësi kërkon që nxënësit të plotësojnë fjalinë vijuese:

“Përgjithësisht është keq të thyesh ligjin sepse...”

Mundësia tjetër është që mësimdhënësi të kërkojë nga klasa të mendojnë për sa më shumë arsye që të munden pse është keq të thyesh ligjin. Si zakonisht, duke ju përgjigjur kësaj pyetje, njerëzit kanë një sërë përgjigjesh, duke përfshirë të mëposhtmet:

“Është keq të thyesh ligjin sepse:

- mund t’u zënë dhe t’u dënojnë;
- ligji i mbron njerëzit nga dëmi dhe është e padrejtë të dëmtosh të tjerët;
- të gjithë do të bënin ç’është donin po të mos i ndalte ligji;
- shkelja e ligjit shkatërron besimin në mes të njerëzve;
- Për të mbijetuar, shoqërisë i nevojiten ligji dhe rendi, pa ligje do të kishte kaos;
- shkelja e ligjit cenon të drejtat individuale të njerëzve, siç janë të drejtat në pronësi, e drejta për jetë.”

Mësimdhënësi i tregon klasës se njerëzit kanë një varg arsyesh për t’ju bindur ligjit. Disa prej këtyre kanë të bëjnë me interesin vetjak, arsyet tjera tregojnë shqetësimin për njerëz të tjerë dhe disa tregojnë shqetësimin për mirëqenien e shoqërisë si tërësi (shih shënimet më poshtë).

Për t’i sqaruar këto koncepte, mësimdhënësi mund të vizatojë një seri të tri radhëve koncentrik në dërrasën e zezë në të cilët shënon “vetjake”, “të tjerët” dhe “shoqëria”, duke filluar nga rrethi i brendshëm. Arsyet e ndryshme duhet shënuar në hapësirën e duhur.

Mësimdhënësi thekson se bindja ligjore në vetvete nuk është domosdoshmërisht shenjë e “qytetarit të mirë”. Shumë veprime të këqija janë kryer nga njerëz të cilët, në të vërtetë, iu kanë bindur ligjit, duke thënë se vetëm kanë “kryer detyrën e tyre”. Në anën tjetër, rrëfimi tregon se, kohë pas kohe edhe njerëzit e mirë mund të mendojnë të shkelin ndonjë ligj të caktuar për arsye të fortë morale.

Për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë ekuilibrin e vështirë në mes të detyrimeve ligjore dhe përgjegjësive morale, mësimdhënësi kërkon që nxënësit të shkruajnë tregimet e tyre të shkurtra, në të cilët njerëzit (për arsye të forta) mendojnë të thyejnë ligjin. Shembujt mund të jenë shkelja e kufirit të shpejtësisë në një rast emergjent ose mospërfillja e ligjit pse ai është i keq apo i padrejtë.

Disa prej nxënësve i lexojnë shembujt e tyre me zë në diskutimin plenar. Në vijim mësimdhënësi nënvizon dallimin në mes të përgjegjësive morale (të cilat njerëzit i marrin përsipër si pjesë e vlerave dhe besimeve të tyre) dhe detyrimeve ligjore, me të cilat njerëzit ngarkohen nga qeveritë. Tendosja

në mes të këtyre dy llojeve të përgjegjësisë mund t'i bëjë qytetarët të kritikojnë disa ligje me të cilat ata nuk pajtohen dhe ata të punojnë për ndryshimin e tyre. Ata madje, herë pas herë, mund të vendosin të shkelin disa ligje për arsye pozitive morale. E kaluara na ofron shumë shembuj të situatave në të cilat njerëzit i kanë shkelur ligjet në mënyrë që t'i kundërshtojnë ato ose të kundërshtojnë qeveritë tiranike. Mësimdhënësi duhet të sqarojë këtë me disa shembuj vendor. Mësimdhënësi duhet të theksojë se veprimet e tilla nuk duhet të merren shkujdesshëm, për shkak se rrezikojnë të dëmtojnë sundimin e ligjit, në të cilën varen demokracitë stabile.

Shënim

Dilema morale e paraqitur në këtë mësim nuk është ndryshe nga e famshmja “Dilema Heinz” e sajuar nga Lawrence Kohlberg, psikologu amerikan, në vitin 1950. Kjo ishte njëra nga një sërë dilemash që të rinjve ua paraqiste Kohlberg dhe kolegët e tij, çdo tri vjet apo më shumë, në mes të moshës 10 dhe 25 vjeçare. U zbulua se të rinjtë, mesatarisht, përparuan me kohë nga përdorimi i arsytimit vetëdashës kur ata ishin të ri, në përdorimin e arsytimit të drejtuar kah personi në adoleshencën e hershme. Më vonë, në adoleshencën e mesme, shumica prej tyre treguan përparim në përdorimin e arsytimit të drejtuar kah shoqëria, edhe pse konteksti dhe dilema mund të kenë ndikim në llojin e arsytimit që e përdorin njerëzit në çdo kohë. Është konstatuar se fëmijët e moshës më të re, rregullat dhe ligjet i konsiderojnë si jofleksibile dhe të bazuar jo në arsyen shoqërore por vetëm në autoritetin e ligjbërësit. Në fazën e adoleshencës, të rinjtë janë më të vetëdijshëm se ligjet kanë qëllime shoqërore, të cilat qëllime mund të rishikohen, të vihen në dyshim dhe të kritikohen pse janë moralisht të papërshtatshëm apo të padrejtë.

Mësimi 3

Problem i kujt është kjo?

Si ndahen përgjegjësitë shoqërore?

Objektivi i mësimnxënies	Të shqyrtohet natyra e ndarjes së përgjegjësive për problemet shoqërore.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit diskutojnë përgjegjësinë për probleme të caktuara shoqërore. Nxënësit plotësojnë një kornizë të të menduarit. Nxënësit përgatisin përgjigje me shkrim për çështjet e shtruara.
Burimet	Kopje të “Ietrës”. Dërrasa e zezë. Letër për detyra individuale të nxënësve me shkrim.
Metodat	Analizë e strukturuar kritike. Analizë në grupe të vogla dhe diskutim. Arritja e konsensusit dhe negociimi. Shkrime personale.

Të mësuarit konceptual

Problemi shoqëror: Një problem me të cilin janë përballur të gjithë ose shumica e pjesëtarëve të një komuniteti, për të cilin përgjegjësia është ndarë nga palët e ndryshme të komunitetit ose nga komuniteti si tërësi. Përgjegjësia për një problem shoqëror nuk ndahet domosdoshmërisht në mënyrë të barabartë në mes të palëve të përfshira.


Shkalla e përgjegjësive: Kufiri për të cilin dikush mund të jetë përgjegjës për një problem shoqëror.

Mësimi

Mësimdhënësi paraqet letrën e imagjinuar dërguar gazetës vendore. Në të përfshihen ankesat për dy probleme shoqërore të cilat i brengosin banorët e qytetit.

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që ata si klasë të: a) identifikojnë çështjet dhe b) bëjnë një listë (për të dyja çështjet) të atyre njerëzve të cilët mund të kenë përgjegjësi. Mësimdhënësi mund të ndihmojë këtë proces duke vizatuar një kornizë të të menduarit në dërrasën e zezë, siç është treguar më poshtë.

Kush është i përfshirë në këtë problem në çfarëdo mënyre?



Puna në grupe

Hapi 1

Ndani klasën në grupe me nga tri apo katër vetë. Çdo personi në grup caktoni numrin e pikëve që të jetë i barabartë me numrin e palëve të përfshira.

Hapi 2

Çdo anëtar i grupi së pari i ndan pikët në mes të palëve në bazë të asaj se si ata mendojnë duhet të ndahet përgjegjësia për problemin. Për shembull, fëmijët dhe qentë mund të mos marrin asnjë pikë, por pronarët e qenve dhe politikanët mund t'i ndajnë pikët në mes tyre, ose njëri prej tyre mund të marr më shumë pikë se tjetri.

Hapi 3

Kur çdo anëtar i grupit të ketë marrë vendimin e tij, ata me rend i shkëmbejnë idetë e tyre me njëri tjetrin, duke i dhënë arsyet e tyre për këtë. Nxënësit mund të ndërrojnë mendimin në këtë fazë. Në fund, çdo grup i mbledh pikët që u janë dhënë çdo pale. Kjo tregon se si grupi si tërësi mendon se duhet të ndahet përgjegjësia për këtë problem.

Mësimdhënësi diskuton me tërë klasën konkludimet e arritura nga grupet e ndryshme. Mësimdhënësi shqyrton opinionet e ndryshme të cilat i kanë paraqitur, duke nxjerrë nga nxënësit arsyet e tyre të theksuara për këto gjykime.

Nëse premtori koha, përsëritni ushtrimin me problemin e plehrave dhe mbeturinave, ose e zëvendësoni me një problem më relevant për lokalitetin e shkollës apo që është më sfidues për kompetencat e grupit.

Shënim

Problemet e dhëna në këto shembuj janë të përshtatshëm për nxënësit të cilët akoma nuk kanë shumë përvojë në diskutimin e problemeve politike. Kjo është për shkak se ata janë konkret, të qartë dhe relativisht lehtë për t'u kuptuar (edhe pse ato akoma janë mjaft vështirë për t'u zgjidhur). Nga klasat

më nxënës më të vjetër apo më të aftë duhet të kërkohet që të diskutojnë probleme më të sofistikuara, siç është papunësia ose racizmi, duke përdorur llojin e njëjtë të kornizës së të menduarit.

Hapi 4: Diskutimet që dalin nga ushtrimi

Në sesionin përfundimtar plenar, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të gjykojnë nëse njerëzit në përgjithësi marrin mjaft përgjegjësi për veprimet e tyre. Nëse jo, të mendojnë si mund të binden ata për ta bërë këtë. A do të ndihmojë edukimi në ndonjë mënyrë? Apo është e domosdoshme të hartohen ligje të reja apo të parashihen dënime më të ashpra? Nëse qeveria lokale apo qendrore do të pranonte përgjegjësinë për probleme të caktuara, pyetni nxënësit për shpenzimet e mundshme dhe si duhet të paguhen ato. Mësimdhënësi gjithashtu mund të kërkojë që klasa të shqyrtojë rolin e të rinjve në trajtimin e problemeve shoqërore të këtij lloji. A duhet ata të lirohen nga përgjegjësia për shkak të moshës së tyre? A është e drejtë që të rinjtë t'ua lënë problemet e komunitetit të rriturve? Problemet e tilla mund të formojnë bazën e një detyre personale me shkrim.

Mësimdhënësi shpjegon nevojën që politikanët në nivel lokal dhe qendror të jenë në dijeni për problemet kur ata të paraqiten. Politika shpesh do të thotë trajtim i problemeve të përbashkëta si komunitet. Kjo nuk do të thotë se qeveritë mund të zgjidhin çdo problem, dhe shumë probleme, në radhë të parë, as që do të paraqiteshin po të merrnin njerëzit më shumë përgjegjësi për pasojat e veprimeve të tyre.

Mësimi 4

Pse njerëzit bëhen qytetarë aktivë?

Pse njerëzit duan ta ndryshojnë shoqërinë dhe si mund ta bëjnë ata këtë?

Objektivat e mësimnxënies	Të shqyrtohen arsyet pse njerëzit pranojnë përgjegjësi për vuajtjet e njerëzve të tjerë. Të shqyrtohet roli i OJQ-ve në shoqërinë civile.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit punojnë në grupe për të bashkuar një tregim. Nxënësit paraqesin supozimet e tyre mbi arsyet për sjelljen e motivuar nga marrëdhëniet shoqërore. Nxënësit shqyrtojnë rolin e OJQ-ve. Në grupe, nxënësit hulumtojnë punën e një OJQ-je apo të një përkrahësi shoqëror. Në grupe nxënësit paraqesin rezultatet e tyre.
Burimet	Kopje të shiritave të letrës për Mia Greenwood (prospektet për nxënës 6.4), tanimë të prerë. Burimet për mbështetjen e punës kërkimore të nxënësve. Burimet për prezente në grup, p.sh. fletë të mëdha të letrës, stilografë me ngjyra.
Metodat	Punë në grupe. Negocim. Arsyetimi moral. Vlerësim kritik. Punë kërkimore. Prezente në grupe.

Të mësuarit konceptual

Veprimi shoqëror: Veprim i ndërmarrë nga qytetarët apo pjesëtarët e komunitetit për trajtimin e një problemi shoqëror.

Qytetari: Dikush që ka anëtarësim ligjor (shtetësi) në një komunitet shtetëror. Shtetësia sjell të drejta dhe detyrime, edhe pse njerëzit ndryshojnë për nga shkalla e ndjenjës së përgjegjësisë që ata e ndiejnë për atë çka ndodh në komunitetin e tyre.

Qytetari aktiv: Dikush që ndërmerr veprime publike për t'ju përgjigjur një problemi shoqëror apo atij të komunitetit.

Organizata joqeveritare (OJQ): Organizatë e themeluar dhe e përkrahur nga qytetarët (jo nga qeveritë) për të trajtuar një problem shoqëror. OJQ-të janë publike, nuk janë të fshehta, dhe ata punojnë brenda strukturës së një shoqërie për të sjellë ndryshime. Ata shpesh trajtojnë çështje në të cilat të drejtat e njerëzve nuk janë të mbrojtura në mënyrë adekuate apo të njohura nga qeveria. OJQ-të mund të punojnë me qeveritë ose të jenë në kundërshtim me ta. Shoqëritë demokratike kanë ligje me të cilat lejohet ekzistimi i OJQ-ve, sigurohen të drejtat e tyre ligjore dhe mbrojtja.

Shoqëria civile: Njerëzit dhe organizatat që ndërmarrin veprime shoqërore, jashtë punës së kryer nga qeveria, konsiderohet se janë pjesë e shoqërisë civile. Shoqëria civile e krijon një pjesë të lidhjes në mes të qytetarëve individual dhe qeverive.

Mësimi

Mësimdhënësi e ndan klasën në grupe me rreth katër nxënës. Në vazhdim ai u jep informacionet për Mia Greenwood (prospektet për nxënës 6.4). Do të ishte më mirë që kjo të pritej në shirita të veçantë të letrës. Mësimdhënësi kërkon që grupet të shkëmbejnë shiritat e letrës kuturu në mes të anëtarëve të grupit. Çdo anëtar i grupit me rend ua lexon me zë shiritin e tij anëtarëve të tjerë të grupit. Pastaj grupi i rregullon shiritat sipas renditjes që më së miri ka domethënie.

Në vijim mësimdhënësi kërkon që nxënësit të diskutojnë pyetjet vijuese si grup dhe, për aq sa është e mundshme, të përfundojnë me një përgjigje grupore. Mësimdhënësi thekson se pjesëtarët e grupit mund të mos pajtohen, por shkëmbimi i ideve jep përgjigje më të mira. Nxënësit në mënyrë individuale mund të shënojnë përgjigjet e tyre. Mësimdhënësi në vijim diskuton çështjet kryesore me klasën, të sugjeruara nga pyetjet vijuese.

Pyetjet

- Çfarë mendoni ju, cilat ishin arsyet kryesore pse Mia Greenwood u përfshi në Grupin 353?
- Nga ajo që dini ju për Mia Greenwood, cilat fjalë do t'i kishit përdorur për ta përshkruar atë?
- Pse sipas mendimit tuaj Mia Greenwood dhe Grupi 353 nuk ia lanë punën që dëshironin ta kryejnë qeverisë?
- Çfarë nevojash përpiqet të plotësojë Grupi 353 ?
- Çfarë shoqërie shpresonin të ndërtojnë Mia Greenwood dhe Grupi 353?
- Sa mendoni se janë të rëndësishme organizatat joqeveritare (sikurse Grupi 353) në shoqëri? Çka mendoni ju se mund të arrijnë ata? Mendoni për rolin e tyre në relacion me punën e qeverive, si dhe në relacion me plotësimin e nevojave (të drejtave) të njerëzve.
- Mendoni për shoqërinë tuaj. Për cilat nevoja jeni ju në dijeni se mund të përkrahen nga individët aktivë ose me marrjen e përgjegjësive nga OJQ-të?

Një shembull nga Evropa Juglindore mund t'i ndihmoj nxënësit për të kuptuar rëndësinë e OJQ-ve. Ky shembull mund të ndërrohet me ndonjë tjetër të zhgjedhur nga mësimdhënësi.

Një raport ndërkombëtar për vitin 2003 për OJQ-të në Bosnje dhe Hercegovinë shkruante:

“Sektori i OJQ-ve në Bosnje dhe Hercegovinë vazhdon të jep kontribute pozitive në procesin e ndërtimit të demokracisë dhe shoqërisë civile. [...]. Aktualisht ka 7874 organizata joqeveritare në Bosnje dhe Hercegovinë, sipas ligjeve të vjetra dhe të reja për regjistrimin e tyre. [...]

Sektori i OJQ-ve u tregua i aftë në drejtimin e fushatave të mëdha publike të cilat përkrahnin ndryshimet në çështjet jetike për shoqërinë e Bosnjës, duke përfshirë rininë, barazinë gjinore, ambientin, mbrojtjen e të drejtave të pakicave, etj. Një numër i madh i OJQ-ve vazhdojnë të ofrojnë shërbime në fushat e kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies shoqërore, rindërtimit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mbrojtjes së ambientit dhe në mbrojtjen e pakicave.”²²

Mësimdhënësi e diskuton këtë citat me nxënësit. Së pari, ata duhet të shqyrtojnë nëse fushat e veprimeve të përmendura në raport vlejnë edhe për vendin e tyre. Pastaj mësimdhënësi kërkon që ata të mendojnë për shembuj të llojit të projekteve, të cilët mund të klasifikohen nën këto fusha të ndryshme të veprimeve.

Puna në grupe

Si detyrë e fundit në këtë njësi, çdo grup mund të merr njërën prej këtyre fushave dhe të përgatisë prezentim lidhur me të, të bazuar në mësim. Mundësia tjetër është, nëse ka mjete për punë kërkimore në dispozicion, të hulumtohet jeta e qytetarëve të tjerë aktivë në atë vend dhe kjo të përbëjë temën e prezentimit të grupit. Nxënësit mund të përfshijnë edhe figura ndërkombëtare siç është Nënë Tereza dhe Nelson Mandela.

22. Burimi: USAID raporti i titulluar “2003 NGO Sustainability Index, Europe and Eurasia“ pp. 42 dhe 43; www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/2003/bosnia.pdf

Prospektet për nxënës 6.1

Andrea bën një zgjedhje

Andrea pothuajse ishte gati të niset për në shkollë kur hyri babai i tij në kuzhinë.

“Andrea, mua vërtetë më duhet ndihma jote sot në ara. A nuk mund të rrish sot në shtëpi dhe të mos shkosh në shkollë? Të mbjellat do të dëmtohen nëse i lëmë të rrinë më shumë në arë.”

Andrea nuk u gëzua.

“Babë, unë sot duhet të shkoj në shkollë,” tha ai, “mbahet takimi i parë i këshillit të nxënësve dhe unë jam zgjedhur përfaqësues i klasave të 8-ta.”

“Por ti nuk do të jesh i vetmi, apo?” tha babai i tij, “Nuk do të ketë rëndësi nëse ti nuk shkoni. Ka edhe përfaqësues tjerë të klasave të 8-ta, apo jo?”

“Po, por unë do t’i zhgënjej njerëzit që më kanë zgjedhur nëse unë nuk shkoj. Përveç kësaj, ne sot kemi mësim nga shkencat natyrore. Unë nuk dua ta humbas këtë orë. Unë duhet t’i kaloj provimet nëse do të shkoj në universitet.”

Babai i Andreas murmuriti trishtueshëm.

“Ti flet për të shkuar në universitet thuajse familja jote nuk ka rëndësi fare. Pse nuk mund ta kuptosh se ne na nevojitesh në shtëpi? Çfarë ndihmese do të jesh për ne nëse shkon në universitet? Dhe ku do të shkosh kur të marrish kualifikimet? Nuk ka gjasa që ti të kthehesh këtu, kjo është e sigurt.”

“Ju duhet të jeni të lumtur që unë dua të përparoj në jetë,” bërtiti Andrea i zemëruar, “ndryshe nga shumica e djemve këtu. Ata nuk kanë ambicie. Ata do të bëjnë punën që e kanë bërë etërit e tyre.”

“Nuk ka asgjë të keqe nëse tregoni pak respekt për gjeneratën e vjetër,” u përgjigj babai i Andreas, duke ju nxehur gjaku. “Të gjitha bisedat për edukim që po zhvillohen këto ditë mua më kanë lodhur. Mua më duket se ti i ke harruar disa nga vlerat e vjetra, për të cilat ne të gjithë kemi punuar së bashku. Vetëm ti je në kërkim të vetvetes.”

Andrea psherëtiu. Ai i kishte dëgjuar të gjitha këto më herët.

“Babë, nëse unë e gjej një punë të mirë, nuk do të harroj ty dhe familjen. Si mund të mendosh se unë mund ta bëj këtë? A vërtetë dëshironi që unë ta lë shkollën dhe të mos e arrij atë për të cilën mendoj se kam aftësi për ta arritur? Të gjithë mësimdhënësit e mi më thonë se unë mund të jem një shkencëtar i mirë. Ndoshta një ditë do të bëj zbulime të cilat do të ndihmojnë gjithë njerëzimin.

Babai i Andreas e goditi tavolinën.

“Detyra juaj e parë është ajo ndaj familjes dhe këtij komuniteti, posaçërisht tani kur kohërat janë kaq të vështira. Ti po e mbush kokën tënde me ëndrra. Ç’bregoseni ju për botën reale?”

Kjo e lëndoi Andrean por ai nuk deshi ta tregoj këtë. Për një sekondë ai ia nguli sytë babait me një heshtje mosbindjeje. Pastaj plaku u kthye dhe doli nga shtëpia, duke e përplasur derën derisa po largohej.

Andrea u ul dhe psherëtiu. Ai mendoi për një çast dhe vendosi. Ai e morri çantën e shkollës dhe u kthye kah dera. Pastaj u ndal, nxori një fletë të letrës dhe u ul t’i shkruaj një letër të shkurtër babait të tij. Kjo ishte gjëja më e vështirë që ai e kishte bërë në jetë.

Prospektet për nxënës 6.2

Dilema e Schmitt

Vajza e vetme e Schmitt është shumë e sëmurë. Ajo urgjentisht duhet t'i nënshtrohet një operacioni, por mjekët e vetëm në atë rajon të cilët mund ta bëjnë këtë operacion kërkojnë para përpara se t'i ofrojnë trajtim mjekësor dikujt. Schmitt nuk din çka të bëjë. Ai dhe gruaja e tij kanë ca kursime, të cilat ata shpresonin se do t'ju ndihmojnë të blejnë një dyqan të vogël. Ata me kënaqësi do t'i jepnin të gjitha këto kursime për të shpëtuar vajzën tyre, por këto nuk janë aspak të mjaftueshme.

Schmitt i lut mjekët që operacionin ta bëjnë për më pak para, por ata thonë se nuk mund ta bëjnë këtë, sepse do të ishte e padrejtë për gjithë të tjerët të cilët duhet të paguajnë çmimin e plotë. Schmitt kërkon nga familja dhe nga shokët e tij që t'i japin ca para hua, por kjo shumë pak e rrit shumën e kërkuar për operacion. Dhe gjatë gjithë kohës vajza e Schmitt vjen duke u ligështuar gjithnjë e më shumë.

Duke qenë në gjendje të dëshpërimit, Schmitt mendon të vjedhë pjesën tjetër të parave për të shpëtuar jetën e vajzës së tij.

Prospektet për nxënës 6.3

Gjërat po dalin jashtë kontrollit!

Shqyrtoni letrën vijuese, e cila u paraqit në një gazetë vendore.

Si një grup i banorëve lokal, ne jemi shumë të shqetësuar për një sërë problemesh, të cilët siç duket po paraqiten për shkak se njerëzit nuk janë të përgatitur që të marrin përgjegjësi për sjelljet e tyre.

Shumë qen po harbohen. Pronarët e tyre ose nuk e dinë ose nuk brengosen për këtë. Qentë i lënë ndyrësitrat e tyre nëpër rrugë, që jo vetëm se është e pakëndshme por mund të jetë edhe rrezik për shëndetin. Disa qen bredhin në tufa dhe janë të egër. Ata duhet të mbahen nën kontroll të rreptë, veçanërisht kur atypari luajnë fëmijë.

Ne gjithashtu mendojnë se shumë plehra janë lënë nëpër qytet dhe në lagjet jashtë qytetit. Kjo është për shkak se njerëzit janë shumë dembelë që ato t'i hedhin ku duhet. Kjo është e neveritshme, dhe i josh minjtë dhe nxit përhapjen e sëmundjeve. Kur njerëzit lënë kuti të vjetra teneqesh me ngjyrë dhe me substanca kimike përreth, këto mund të hyjnë në përrenj dhe lumenj dhe të ndikojnë në furnizimin me ujë të pijshëm.

Pse njerëzit nuk mendojnë më shumë për efektet e veprimeve të tyre? Dhe përse politikanët nuk bëjnë diçka për këto probleme?

Sinqerisht,

Prospektet për nxënës 6.4

Klasifikimi i skedave: jeta e Mia Greenwood

1. Mia Greenwood u lind në vitin 1944.	2. Mia Greenwood vdiq nga kanceri në vitin 2000.
3. Pasi Mia vdiq, disa nga miqtë e saj e morën një gurë nga një ndërtesë e bombarduar në vendlindjen e saj. Guri u dekorua nga fëmijët refugjatë. Pastaj guri u vendos në një park në Berlin. Ky park ishte emëruar “Parku i Paqes” në kujtim të Mia Greenwoodit.	4. Mia Greenwood dhe Grupi 353 drejtuan Projektin në vendlindjen e Mias, që ndihmoi ndërtimin e besimit në mes të grupeve të ndryshme etnike. Mia Greenwoodit iu bashkuan vullnetarë nga të dyja anët por edhe nga bashkësia ndërkombëtare në këtë projekt.
5. Mia Greenwood ishte themeluese dhe udhëheqëse e një organizate të quajtur Grupi 353. Grupi 353 është një organizatë joqeveritare (OIQ). Grupi 353 inkurajon zgjidhjen e konfliktit në mënyrë të padhunshme, nxit tolerancën dhe bashkëpunimin, si bazë për ndërtimin e shoqërive humanitare.	6. Mia Greenwood shkroi artikuj kundër nacionalizmit dhe racizmit, të cilët u botuan ndërkombëtarisht. Ajo u shpërblye me një çmim ndërkombëtar për paqe për punën e saj nga një organizatë e quajtur Pax Christi.
7. Në Berlin është një park i paqes i quajtur Mia Greenwood, për nder të saj dhe në shenjë vlerësimi të punës që ka bërë ajo. Mia kishte folur në një takim publik në këtë park.	8. Mia Greenwood u bë balerinë e famshme ndërkombëtare dhe mësimdhënëse e baletit.
9. Mia Greenwood ka bërë fushata kundër luftës dhe ajo luftoi për të drejtat e njeriut për të gjithë njerëzit. Ajo dhe organizata e saj kanë punuar shumë për të ndihmuar refugjatët të cilët largohen nga lufta.	10. U quajt Grupi 353 sepse në projektin e tij të parë punoi me 353 familje të cilat kishin mbetur pa shtëpi për shkak të luftës. Grupi 353 refugjatëve u ofroi ndihmë, rehati dhe këshilla për të drejtat e tyre.